

# RAPORTI I VETËVLERËSIMIT NË KUADËR TË AKREDITIMIT INSTITUCIONAL

KOLEGJI UNIVERSITAR BEDËR



RAPORTI I  
VETËVLERËSIMIT  
NË KUADËR TË  
AKREDITIMIT  
INSTITUCIONAL  
KOLEGJI  
UNIVERSITAR  
BEDËR

Prill 2017  
[www.beder.edu.al](http://www.beder.edu.al)







# KOLEGJI UNIVERSITAR BEDËR

**Kolegji Universitar “Bedër”**

## RAPORTI I VETËVLERËSIMIT NË KUADËR TË AKREDITIMIT INSTITUCIONAL

### GRUPI I VETËVLERËSIMIT:

- |                       |                  |
|-----------------------|------------------|
| 1. Dr. Isa Erbaş      | Kryetar          |
| 2. Dr. Nertil Bërdufi | Anëtar           |
| 3. Norga Sulo         | Anëtare          |
| 4. Aranit Qinami      | Anëtar           |
| 5. Sefer Vrana        | Anëtar (student) |
| 6. Laurela Muça       | Anëtare          |



Tiranë, më: 13.4.2017



## Përmbajtja

Hyrje në procesin e vetëvlerësimit .....	6
Etapat e procedurës së vlerësimit të brendshëm nga IAL .....	7
Historiku i IAL-së .....	8
1. Fusha e vlerësimit: Organizimi dhe menaxhimi i institucionit .....	10
2. Fusha e vlerësimit: Burimet .....	18
3. Fusha e vlerësimit: Kurrikula .....	28
4. Fusha e vlerësimit: Mësimdhënia, mësimnxënia, vlerësimi dhe kërkimi .....	36
5. Fushat e vlerësimit: studentët dhe mbështetja e tyre .....	46
Përfundimet dhe vlerësimi përgjithshëm .....	53
Lista e evidencave mbështetëse të IAL-së .....	58

## Hyrje në procesin e vetëvlerësimit

Në mbështetje të nenit 103 dhe të nenit 104 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, statutit të Kolegjit Universitar “Bedër”, si dhe urdhrorit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për miratimin e standardeve shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin institucional të institucioneve të arsimit të lartë”, nën përgjegjësinë e titullarit të institucionit, rektorit Prof. Dr. Ferdinand Gjana, u ngrit Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB) institucional.

Në përzgjedhjen e anëtarëve të GVB janë marrë parasysh kompetencat profesionale, paanshmëria, mundësitë për grumbullimin e informacionit për të kryer vlerësimin dhe shkallën e nevojshme të njohjes të anëtarëve të grupit. Grupi është ngritur qëllimisht për misionin e vlerësimit të brendshëm (grup ad-hoc). GVB-ja përfaqëson të dyja njësitë kryesore të kolegjit, duke përfshirë dhe përfaqësues të studentëve, si dhe është ngritur duke marrë parasysh edhe shpërndarjen e detyrave të secili anëtar.

Ky proces rivlerësimi i jashtëm institucional vjen pas një përvoje akreditimi të vitit 2013, të cilin institucioni ynë e kaloi me sukses,<sup>1</sup> çka do të thotë që institucioni ka qenë gjithmonë i angazhuar për sigurimin e brendshëm të cilësisë në të gjitha strukturat e tij. Jo vetëm kaq, por Kolegji Universitar “Bedër” ka ngritur që në fillimet e tij edhe Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, si njësi bazë e përhershme për të kontrolluar dhe për të garantuar përmbushjen e standardeve në këtë drejtim. Një tjetër aspekt me rëndësi ka qenë dhe marrja e certifikatës së cilësisë ISO 9001:2008.<sup>2</sup>

Duke filluar nga viti 2012, çdo njësi bazë dhe kryesore e Kolegji Universitar “Bedër”, çdo fundviti akademik, dorëzon në Rektorat raportin vjetor, i cili në vetvete është një model i vlerësimit të brendshëm të njësisë.<sup>3 4</sup>

Raporti i vetëvlerësimit u diskutua në çdo njësi, nga ku dolën mendime dhe sugjerime të cilat plotësuan hartimin e raportit përfundimtar.

---

<sup>1</sup> Evidenca nr.43

<sup>2</sup> Evidenca nr.48

<sup>3</sup> Evidenca nr.71

<sup>4</sup> Evidenca nr.72

## **Etapat e procedurës së vlerësimit të brendshëm nga IAL**

1. Ftesë nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë për aplikim për fillimin e procesit të vlerësimit të jashtëm institucional me Agjencinë Britanike të Sigurimit të Cilësisë (QAA)<sup>5</sup>
2. Kërkesë për fillimin e procesit të vlerësimit të jashtëm institucional nga ana e Kolegjit Universitar “Bedër”
3. Pranimi i kërkesës dhe njoftimi për trajnimin e grupit të punës mbi sistemin e menaxhimit të APAAL
4. Ngritja e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm nga titullari i institucionit
5. Trajnimi i GVB nga stafi i APAAL-it; për këtë vihen në dispozicion materialet udhëzuese për vlerësimin, organizimin e grupit dhe procesin, detyrat, të drejtat e përgjegjësitë e secilit.
6. Kryerja e vlerësimit të brendshëm sipas udhëzimeve përkatëse të APAAL-it.
7. Përgatitja e dosjes së vetëvlerësimit .
8. Hartimi i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB), sipas kërkesave e udhëzimeve në këtë udhëzues dhe pas konsultimit të përmbajtjes së tij me personelin e institucionit.
9. Dorëzimi në APAAL i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm bashkë me të gjithë dokumentacionin mbështetës.

---

<sup>5</sup> Evidenca nr.42

<sup>6</sup> Evidenca nr.45

## Historiku i IAL-së

Kolegji Universitar “Bedër” u çel me kërkesë të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe vendimin nr.286, datë 6.4.2011 të Këshillit të Ministrave, me anë të të cilit u miratua dhënia e licencës për ushtrimin e aktivitetit si institucion i arsimit të lartë. Kolegji Universitar “Bedër” është një institucion në fushën e arsimit të lartë, i cili funksionon si organizatë jofitimprurëse. Akreditimi institucional, por edhe i të gjitha programeve të studimit që ofrohen është një treguesi i rëndësishëm i cilësisë dhe strandarteve të Kolegjit Universitar “Bedër”.<sup>7</sup>

Kolegji Universitar “Bedër” ofron programe studimi në fushën e shkencave humane dhe sociale, duke synuar të sjellë një profil të qartë në tregun e arsimit të lartë shqiptar dhe atë ndërkombëtar.

Kolegji Universitar “Bedër” synon paseshtur rritjen e cilësisë akademike dhe institucionale, e cila i ka përcaktuar vizionin e funksionimit, që nuk synon masivitetin, por cilësinë. Kapaciteti studentor maksimal afatmesëm i parashikuar i kolegjit universitar është 1250-1500 studentë në të gjitha programet, për nivelet e studimit të ciklit të parë dhe ciklit të dytë (bachelor, master).

Kolegji Universitar “Bedër” ka vendosur si synim të tij krijimin dhe konsolidimin e një profili ndërkombëtar. Në këtë këndvështrim, gjatë gjashtë viteve të aktivitetit të tij, institucioni ka mundur pranimin e studentëve nga trevat shqipfolëse në rajon dhe në diasporë, si edhe nga disa vende të Evropës dhe më gjerë.

Harta e shteteve nga vijnë studentët është zgjeruar vazhdimisht përgjatë gjashtë viteve duke kapur shifrën 16 (gjashtëmbëdhjetë). Përbërja e stafit akademik, pasqyron gjithashtu profilin ndërkombëtar të kolegjit, i cili përforcohet me bashkëpunimet e vendosura nëpërmjet marrëveshjeve me universitete dhe kompani në disa vende të botës.

Kolegji Universitar “Bedër” operon mbi baza jofitimprurëse dhe mbështet studentët e suksesshëm, të cilët duan të vazhdojnë studimet e larta pranë tij. Gjatë 6 viteve të aktivitetit të tij në Kolegjin Universitar “Bedër” kanë studiuar dhe vazhdojnë studimet 621 studentë që përfitojnë zbritje nga tarifat e studimit.<sup>8</sup>

Kolegji Universitar “Bedër”, që nga fillimi i aktivitetit akademik ka organizuar konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, seminare të hapura, veprimtari kualifikuese e nxitëse, duke dhënë një kontribut në shkencë dhe shoqëri.<sup>9</sup>

---

<sup>7</sup> Evidenca nr.43

<sup>8</sup> Evidenca nr.109

<sup>9</sup> Evidenca nr.58



Për përmbushjen e misionit të tij, KUB ofron programe studimesh në përputhje të plotë me të gjithë komponentët e strategjisë për zhvillimin e institucionit. Programet e ofruara janë si më poshtë<sup>10</sup>:

**Bachelor në:**

1. Drejtësi;
2. Shkenca komunikimi;
3. Shkenca islame;
4. Gjuhë dhe letërsi turke;
5. Gjuhë dhe letërsi angleze;
6. Arsim parashkollor dhe fillor;
7. Psikologji këshillimi dhe pedagogji.

**Master i Shkencave në:**

8. Drejtësi. Profilet: e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare;
9. Shkenca komunikimi. Profilet: marrëdhënie me publikun dhe gazetari;
10. Shkenca moderne islame;
11. Shkenca themelore islame;
12. Psikologji këshillimi dhe pedagogji;
13. Gjuhë dhe letërsi turke;
14. Gjuhë dhe letërsi angleze.

**Master profesional në:**

15. Mësuesi, gjuhë angleze për arsimin e mesëm;
16. Mësuesi, gjuhë turke për arsimin e mesëm.

Programet e studimit në të dyja ciklet organizohen në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuara nga Karta e Bolonjës dhe legjislacioni shqiptar për arsimin e lartë.

Aktivitetet me bazë kërkimore janë një kriter i rëndësishëm për profesionalizmin që karakterizon punën brenda KUB. Mbështetur në një filozofi të qartë mbi nivelin e arsimit që ofron, si pjesë e një fondacioni arsimor dhe me status jofitimprurës, liria akademike dhe autonomia e kolegjit ndihmojnë për të realizuar idetë e planifikuara, por nga ana tjetër, të gjitha këto janë të shoqëruara me përgjegjësi për vendimet e ndërmarra. Hapja ndaj ideve të reja, bashkëpunimi mes njerëzve, organizatave dhe fushave kërkimore, si dhe qasja me në qendër zhvillimin e vlerave humane kontribuojnë në ndryshime pozitive në kolegji dhe botën rreth tij.

---

<sup>10</sup> Evidenca nr.38

## 1. Fusha e vlerësimit: Organizimi dhe menaxhimi i institucionit

Autonomia
<p><b>Institucioni dhe strukturat e tij funksionojnë në përputhje me statutin e institucionit.</b></p> <p>Statuti sipas ligjit të mëparshëm<sup>11</sup>, rregullorja themelore<sup>12</sup>, rregullorja mbi organizimin akademik<sup>13</sup>, rregullorja mbi organizimin administrativ<sup>14</sup>, si dhe statuti sipas ligjit të ri i Kolegjit Universitar “Bedër”<sup>15</sup> janë hartuar nga njësitë e Kolegjit, respektivisht në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore përkatëse, si dhe të ligjit të ri për arsimin e lartë nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.”</p> <p>Rregulloret kanë si qëllim të sigurojnë kuadrin ligjor për organizimin akademik dhe administrativ të institucionit, duke garantuar mbarëvajtjen e veprimtarisë akademike dhe administrative të KUB.</p> <p>Të gjitha rregulloret, udhëzimet dhe aktet e tjera të brendshme të institucionit janë hartuar në përputhje dhe harmoni të plotë me statutin e KUB, i cili është i miratuar edhe nga Ministria përgjegjëse për arsimin<sup>16</sup>. Të gjitha aktet e brendshme janë në përputhje me misionin dhe objektivat e institucionit, të shprehura qartazi dhe në statutin e tij.<sup>17</sup></p> <p>KUB është i angazhuar për përshtatjen dhe përmirësimin në mënyrë të vazhdueshme të rregulloreve, udhëzimeve dhe statutit, në përputhje me kërkesat dhe propozimet e marra nga njësitë bazë, kryesore, si dhe nga qeverisja studentore, të cilat diskutohen në Senatin akademik, gjë kjo që përbën një element pozitiv për funksionimin e institucionit.<sup>18</sup></p>
<p><b>Institucioni organizohet në mënyrë të tillë që të sigurojë efikasitet në menaxhim.</b></p> <p>Menaxhimi i institucionit realizohet në bazë të kompetencave të organeve drejtuese, të përcaktuara në statutin dhe rregulloret e KUB, të cilat ushtrojnë në mënyrë efektive detyrat e tyre. Detyrat dhe përgjegjësitë e njësive akademike janë të përcaktuara në rregulloren për organizimin akademik<sup>19</sup>, ndërsa ato të njësive administrative, përcaktohen në rregulloren e organizimit administrativ.<sup>20</sup></p>

<sup>11</sup> Evidenca nr.1

<sup>12</sup> Evidenca nr.3

<sup>13</sup> Evidenca nr.4

<sup>14</sup> Evidenca nr.5

<sup>15</sup> Evidenca nr.2

<sup>16</sup> Evidenca nr.44

<sup>17</sup> Evidenca nr.1: Neni 4

<sup>18</sup> Evidenca nr.36

<sup>19</sup> Evidenca nr.4

<sup>20</sup> Evidenca nr.5

Zyra e financës, pas marrjes së kërkesave nga njësitë përkatëse, në bashkëpunim me kancelarin e institucionit, harton projektbuxhetin dhe e propozon atë në Këshillin e Administrimit. Buxheti, më tej, diskutohet në mbledhjen e Këshillit të Lartë, i cili është organi më i lartë vendimmarrës dhe që vendos për ndryshime të mundshme.<sup>21</sup>

Buxheti në KUB hartohet nëpërmjet një qasjeje njësi bazë-menaxhim. Planifikimi bëhet në bazë të nevojave dhe propozimeve të njësive përkatëse, kurse shpërndarja bëhet respektivisht në njësitë në fjalë.

Gjithashtu, hartimi dhe zbatimi me sukses i planit strategjik 2012-2017<sup>22</sup>, si dhe ngritja e grupit të punës për hartimin e planit të ri strategjik 2017-2022, është një tjetër hap i rëndësishëm në menaxhimin dhe funksionimin me rendiment të institucionit.<sup>23</sup>

#### **Institucioni favorizon debatin konstruktiv.**

Në bazë të procedurave të brendshme të KUB, rendi i ditës, së bashku me dokumentacionin përkatës, vihen në dispozicion të anëtarëve të këshillave përkatëse, para mbledhjes në fjalë. Procedurat e mbledhjeve për njësi dhe këshilla të ndryshëm përcaktohen në statutin e institucionit dhe në rregulloret përkatëse.

Me propozim të rektoratit, kalendari i mbledhjeve miratohet në fillim të çdo viti nga këshillat respektivë. Rregulloret e brendshme përcaktojnë në mënyrë të qartë përgjegjësitë dhe detyrat e senatit, si dhe të këshillave të tjerë, të cilat në shumicën e rasteve kanë fuqi vendimmarrëse dhe jo vetëm propozuese. Senati dhe ekipet drejtuese mbledhen në mënyrë periodike, në përputhje me rregulloret përkatëse.

Duke synuar mbarëvajtjen e plotë të proceseve këshillimore dhe vendimmarrëse, si dhe ndjekjen e zbatimit të vendimeve, institucioni ndjek procedura të përcaktuara për organizimin e mbledhjeve të njësive të ndryshme.<sup>24</sup>

#### **Institucioni respekton kufijtë e autonomisë së tij.**

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (më parë me emërtimin këshilli i vlerësimit akademik dhe zhvillimit të cilësisë dhe këshilli i sigurimit të cilësisë), i cili ka ndryshuar emërtimin për të siguruar përshtatshmëri të plotë me ndryshimet ligjore dhe statutore, është organi përgjegjës për vëzhgimin dhe koordinimin e veprimtarive të ndërmarra, në kuadër të menaxhimit dhe vlerësimit akademik dhe administrativ, zhvillimin e cilësisë, vlerësimin e jashtëm<sup>25</sup>, kontrollin periodik dhe përmbushjen e sugjerimeve të bëra.

<sup>21</sup> Evidenca nr.60

<sup>22</sup> Evidenca nr.33

<sup>23</sup> Evidenca nr.46

<sup>24</sup> Evidenca nr.59

<sup>25</sup> Evidenca nr.56

Me ndryshimin e ligjit të arsimit të lartë dhe miratimin e statutit të ri të KUB, institucioni ka ngritur dy komisionet e përhershme<sup>26</sup> : Komisioni i përhershëm për kërkimin shkencor, projektet, aplikimet dhe inovacionin dhe Komisioni i përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit.<sup>27</sup> Komisioni i dytë dhe njësia e sigurimit të cilësisë kanë autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me veprimtaritë mësimore dhe shkencore. NJSBC ka bërë pjesë integrale të organizimit dhe funksionimit të saj, standardet e vendosura nga organizma të cilat do të garantojnë “certifikimin e cilësisë”, duke marrë në konsideratë parashikimet dhe detyrimet që lindin nga karta e Bolonjës dhe legjislacioni në fuqi.<sup>28 29</sup>

Për të ndihmuar mirëfunksionimin e NJSBC, Senati<sup>30</sup> ka vendosur zgjedhjen e një eksperti të jashtëm pranë njësisë dhe komisionit, të cilët janë përzgjedhur në bazë të eksperiencës në fushën akademike dhe njohjes së sistemit të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. Në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, misionin e tij dhe objektivat e përcaktuara në planin strategjik, një nga synimet e KUB është tërheqja e financimeve nga programet evropiane dhe me gjerë.<sup>31</sup> Për përmbushjen e këtij objektivi, në institucion janë ngritur dhe funksionojnë dy zyra, përkatësisht zyra e IRO-s dhe zyra e kërkimit shkencor, të cilat janë të organizuara në mënyrë që të mbështesin dhe të lehtësojnë përfitimin e fondeve nga programet e BE-së dhe më gjerë. Zyra e marrëdhënieve ndërkombëtare (IRO) ka në përbërje të saj koordinatorin për programin Erasmus + që bën të mundur marrjen dhe shpërndarjen e informacionit, lidhur me projektet dhe procedurat e aplikimit. Zyra e kërkimit shkencor shërben si organ koordinues ndërmjet institucioneve donatore dhe institucionit, mbështet institucionin dhe personelin akademik lidhur me informacionin mbi thirrjet e hapura për projekte dhe financime, si dhe aspektet teknike të procedurave të aplikimit.<sup>32</sup>

### **Institucioni harton një strategji zhvillimi.**

Senati i KUB, pas diskutimesh në plan të gjerë me të gjitha njësitë, në datë 5.10.2012, në mbledhjen nr.2012/001 me vendim nr. 4 ka miratuar planin strategjik 5-vjeçar të institucionit.<sup>33</sup> Pas vlerësimit të procesit të mbarëvajtjes së vitit të parë akademik 2011-2012 dhe përcaktimit të detyrave, komiteti këshillues mbi planin strategjik nisi takimet e punës në qershor të vitit 2012, duke përcaktuar si sfidë primare të institucionit:

<sup>26</sup> Evidenca nr.47

<sup>27</sup> Evidenca nr.2: Neni 8, neni 27

<sup>28</sup> Evidenca nr.9

<sup>29</sup> Evidenca nr.21

<sup>30</sup> Evidenca nr.37

<sup>31</sup> Evidenca nr.33: Pika 5.3, Pika 5.5.3

<sup>32</sup> Evidenca nr.11; Evidenca nr.104

<sup>33</sup> Evidenca nr.34

Ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë akademike të Kolegjit Universitar “Bedër” në kontekstin e arsimit të lartë në Shqipëri. Në këtë këndvështrim, plani strategjik, në përmbushje të misionit të institucionit, synonte zhvillimin në tri fusha kryesore: mësimdhënie, kërkim shkencor dhe kontribut në shoqëri. Disa nga objektivat e këtij plani janë: arritja e një programi ndërkombëtar kërkimi shkencor, bazuar në programet disiplinare dhe ndërdisiplinare; mësimdhënie bashkëkohore për të dyja nivelet, e karakterizuar kjo nga bashkëpunimi i ngushtë me studentë dhe akademikë të njohur; tërheqja, përgatitja dhe mbajtja e personelit akademik cilësor të një niveli ndërkombëtar dhe mundësimi që KUB të bëhet zgjedhja e parë e këtij kontingjenti studiuesish në shkallë kombëtare e më gjerë. Planin strategjik ka përcaktuar objektiva të qartë, si dhe strategjitë dhe instrumentet përkatëse për arritjen e tyre. Mbarëvajtja e planit strategjik është ndjekur në vijimësi nga rektorati. Gjatë zbatimit të tij, plani strategjik për vitet 2012-2017 ka pasur edhe ndryshime si rezultat i sugjerimeve nga Këshilli i Sigurimit të Cilësisë.<sup>34</sup>

Strategjia e institucionit është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e KUB. Aktualisht institucioni ka ngritur grupin e punës për përgatitjen e planit të ri strategjik për periudhën 2017-2022, i cili ka në përbërje të tij përfaqësues të rektoratit, departamenteve, njërive kryesore, si edhe përfaqësues të studentëve të diplomuar dhe senatit studentor, për të siguruar një përfaqësim sa më të plotë e gjithëpërfshirës.<sup>35</sup>

#### **Institucioni publikon raportin vjetor, e paraqet atë pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe para personelit akademik e studentëve.**

Në fund të vitit akademik, KUB përgatit raportin vjetor të aktiviteteve dhe institucional të institucionit. Një kopje e këtij raporti i dorëzohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Raporti i plotë institucional bëhet publik edhe nëpërmjet faqes së internetit (<http://qac.beder.edu.al/pages.php?s=9>).<sup>36</sup> Çdo anëtar i ekipit akademik të KUB njihet me raportin në fjalë.

Duke analizuar punën e një viti, raporti ndihmon për vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të institucionit. Ai merret si bazë për përmirësimin e cilësisë, si një tregues i transparencës institucionale dhe i rritjes së besueshmërisë nga palët e treta. Raporti i aktiviteteve vihet në dispozicion të këshillave të KUB dhe publikohet në faqen e internetit të institucionit.<sup>37</sup>

<sup>34</sup> Evidenca nr.35

<sup>35</sup> Evidenca nr.46

<sup>36</sup> Evidenca nr.57

<sup>37</sup> Evidenca nr.58

## Organizimi i institucioneve të arsimit të lartë

### Institucioni ngre struktura të përshtatshme për realizimin e misionit dhe qëllimit të tij.

Liria akademike parashikohet në nenin 6 të statutit institucional. “Personeli akademik i KUB gëzon liri akademike në procesin mësimor dhe në kërkimet shkencore në kuptimin e ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.<sup>38 39</sup>

KUB vlerëson mbështetjen e kërkimit shkencor, me qëllim vënien në jetë të ideve dhe projekteve, të cilat ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe të mbarë shoqërisë. Autonomia dhe liria akademike janë elemente kyç, të cilat ndihmojnë në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit.

Në ushtrimin e lirisë akademike, personeli i KUB duhet të mbajë një qëndrim të ndershëm dhe të përgjegjshëm, për t'i dhënë komunitetit shkencor dhe shoqërisë metodologjinë, rezultatet, përplotësimin dhe ndikimin etik të kërkimeve. Edhe sipas udhëzimit mbi nxitjen e publikimeve dhe të kërkimit shkencor, institucioni mbështet pjesëmarrjen në aktivitete shkencore dhe angazhimin në projekte kërkimore, si edhe shpërblen arritjet akademike vjetore mbi të dhëna transparente, të parashikuara në udhëzimin përkatës.<sup>40</sup>

KUB organizohet në 2 fakultete: Fakulteti i Shkencave Humane dhe Fakulteti i Filologjisë dhe Edukimit. KUB ka në përbërje të tij 6 njësi bazë departamente, dy qendra kërkimore zhvillimore,<sup>41</sup> si edhe njësitë ndihmëse administrative, sipas organigramës së miratuar.<sup>42</sup> Njësitë e lartpërmendura operojnë në bazë të parimit të autonomisë brenda kompetencave të tyre.

KUB ofron programe studimi në dy cikle: cikli i parë i studimeve “Bachelor” dhe cikli i dytë i studimeve “Master i shkencave” dhe “Master profesional”.<sup>43</sup> KUB gëzon statusin e institucionit të arsimit të lartë, si Kolegji Universitar, i licencuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr.286, datë 6.4.2011.

Siç është e qartë edhe nga aktiviteti shkencor, KUB ka zhvilluar konferenca të ndryshme shkencore dhe publikime të stafit akademik. Pikësynimi ka qenë kërkimi shkencor aplikativ. Duke synuar ruajtjen e cilësisë dhe efikasitetin në menaxhim, KUB ka përqendruar aktivitetin e tij vetëm në Tiranë, duke mos e parë të arsyeshme hapjen e filialeve të tjera. Departamentet kanë në përbërje të tyre, të paktën, 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët, të paktën, 3 janë me grada dhe tituj.<sup>44</sup> Institucioni ka faqen e tij zyrtare të internetit, e cila mund të aksesohet në adresën: ***www.beder.edu.al***

<sup>38</sup> Evidenca nr.1: Neni 6; Evidenca nr.2: Neni 2

<sup>39</sup> Evidenca nr.2: Neni 87

<sup>40</sup> Evidenca nr.23

<sup>41</sup> Evidenca nr.16, Evidenca nr.17

<sup>42</sup> Evidenca nr.32

<sup>43</sup> Evidenca nr.87

<sup>44</sup> Evidenca nr.83



**Organet drejtuese lehtësojnë vendimmarrjen nëpërmjet favorizimit të debatit në këshillat e institucionit.**

Në KUB funksionojnë organet e mëposhtme: Në drejtim të institucionit: Senati, Këshilli i Administrimit të institucionit dhe Këshilli i Lartë. Në drejtim të njësive kryesore është këshilli i fakultetit dhe në drejtim të njësive bazë të departamentit funksionon këshilli i departamentit. Këto këshilla dhe struktura janë në proces ndryshimi, për shkak të miratimit të ligjit të ri dhe statutit të ri të IAL-së. Informacion më i detajuar për kompetencat dhe funksionet e këshillave në fjalë gjenden në nenet respektive në statut, në rregulloren themelore, në rregulloren për organizimin akademik dhe në rregulloren për organizimin administrativ, që përcaktojnë mënyrën e mbledhjes dhe vendimmarrjes në organet kolegjiale.

KUB vlerëson diskutimin me bazë të gjerë pjesëmarrjeje. Kompetencat e parashikuara në statut dhe në rregulloret respektive, tregojnë qartë aftësinë e këshillave për të dhënë mendime dhe propozime, si edhe për të marrë vendime. Në bazë të procedurës së vendimmarrjes, pasi bëhet zbardhja e vendimeve të marra nga këshillat respektive, bëhet komunikimi në mënyrë shkresore ndaj njësive që preken nga vendimi në fjalë, kurse disa vendime u dërgohen me e-mail në formë të skanuar personave dhe njësive që preken. Në këtë mënyrë, në bazë të parimit të hierarkisë institucionale, personeli akademik dhe administrativ përfshihet në debatin e brendshëm.

**Partneriteti****Institucioni kryen studimin e tregut për realizimin e misionit dhe qëllimit të tij.**

Me qëllimin e informimit të të gjithë stafit akademik dhe administrativ të KUB rreth zhvillimeve në vend dhe në rajon, institucioni është pajtuar në të gjitha të përditshmet shqiptare, si dhe në revistat më të rëndësishme në vend dhe rajon. Monitorimi i zhvillimeve ekonomike rajonale nga zyra e medias, i dërgohet në mënyrë periodike rektoratit, i cili analizon të dhënat dhe, në rast nevojë, bën sugjerimet dhe përshtatjet e nevojshme në planin strategjik. Këto të dhëna mblidhen edhe nga bordet e krijuara, workshopet dhe tryezat e rrumbullakëta me specialistë të fushave dhe përfaqësues të IAL-ve të cilët ofrojnë programe të ngjashme studimi.

KUB, aktualisht, ka 497 të diplomuar dhe në strukturat e dekanatit studentor, funksionon zyra e të diplomuarve, si dhe ajo e planifikimit të karrierës. Funksionimi i kësaj njësie dhe vëzhgimi i të diplomuarëve parashikohen në rregulloren e organizimit administrativ.<sup>45</sup>

Për të mbështetur të diplomuarit, KUB vlerëson si mjaft të rëndësishëm bashkëpunimin me institucione, kompani publike dhe private. Duke u bazuar në moton institucionale “në emër të vlerave”, gjatë gjithë fushatave promovionale dhe zhvillimit të aktivitetit akademik, KUB i kushton një

<sup>45</sup> Evidenca nr.5: Neni 42

rëndësi të veçantë dhe zbaton me përpikëri rregullat e konkurrencës. KUB vlerëson punën e institucioneve homologe, duke ofruar jo rrallë edhe mundësi bashkëpunimi në organizime shkencore.<sup>46</sup> Nga 497 të diplomuarit e tre viteve të fundit 87% e tyre janë punësuar ose vazhdojnë studimet në një cikël të mëtejshme, master ose doktoraturë.<sup>47</sup>

**Institucioni ndjek një strategji të hapur për bashkëpunimin dhe partneritetin në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar.**

KUB ndjek një strategji të hapur për bashkëpunimin në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar për realizimin e misionit dhe të qëllimit të tij. KUB ndjek një politikë favorizuese me institucionet e huaja arsimore, me të cilat ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për gatishmërinë e personelit akademik dhe të studentëve, organizimin e përbashkët të konferencave dhe projekteve, si edhe trajnimet profesionale dhe praktikant studentore. Aktualisht institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me rreth 56 institucioneve, mes të cilave universitete, bashki, institucione publike dhe private.<sup>48</sup> Strategjia për bashkëpunimet e mundshme pasqyrohet në strategjinë afatgjatë të zhvillimit të institucionit. Institucioni merr parasysh sugjerimet e studimeve të tregut të punës të organizuara nga departamentet për programet respektive. Nisur nga sugjerimet e bëra në studimet e tregut nga departamentet përkatëse, janë propozuar edhe ndryshime në kurrikulën e disa programeve në proces riorganizimi, apo edhe programe të reja. Një ndër objektivat e paraqitura në Planin strategjik është përditësimi i programeve mësimore dhe kërkimi shkencor sipas nevojave të tregut. Ky kriter parashikohet edhe në pikën 5.2 dhe 5.3 të Planin strategjik të institucionit.

**Institucioni ndjek një strategji bashkëpunimi me institucione të tjera mbështetëse.**

KUB bashkëpunon me institucione të tjera për ofrimin e shërbimeve ndaj studentëve. Këto shërbime variojnë në bazë të nevojave, si ato shëndetësore, strehimi në konvikte, profesionale etj. Në kuadër të plotësimit të nevojave të veta në funksionim të programeve të studimeve, KUB ka nënshkruar disa marrëveshje me institucione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.<sup>49</sup>

Një rëndësi të veçantë kanë edhe marrëveshjet e nënshkruara me institucione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, për realizimin e praktikave të ndryshme profesionale.<sup>50</sup> Kontrata bashkëpunimi për zhvillimin e programeve të studimit.

<sup>46</sup> Evidenca nr.54

<sup>47</sup> Evidenca nr.84

<sup>48</sup> Evidenca nr.92

<sup>49</sup> Evidenca nr.92

<sup>50</sup> Evidenca nr.92



**Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e personelit akademik dhe të studentëve në nivel ndërkombëtar.**

*(Kreu III Standardi III.4)*

Gjatë viteve akademike 2011-2012 deri në vitin akademik 2016-2017, KUB ka organizuar rreth 26 konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare në bashkëpunim me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. Gjithashtu, anëtarët e personelit akademik të KUB kanë marrë pjesë në veprimtari të rëndësishme jashtë vendit. Me institucionet arsimore të huaja, me të cilat KUB ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, ndjek një politikë favorizuese për lëvizshmërinë e personelit akademik dhe të studentëve, organizimin e konferencave ndërkombëtare, të projekteve të përbashkëta kërkimore dhe trajnime profesionale e stazhe studentore.<sup>51</sup> Numri i studentëve të huaj në këto vite akademike ka mundësuar arsimimin e studentëve nga 16 vende të ndryshme të botës, të cilët përbëjnë rreth 25% të numrit të përgjithshëm të studentëve. KUB, duke synuar të ndjekë një politikë integruese për personelin akademik të ftuar dhe të studiuesve të huaj, ka punësuar pedagogë të huaj nga shtete të ndryshme të botës, si Turqia, SHBA, Anglia, Gjermania, Spanja, Kosta Rika dhe Kosova. Një pjesë e profesorëve të ftuar kanë ardhur në kuadër të marrëveshje të bashkëpunimit me universitete të ndryshme.

**Përfundimi dhe vlerësimi**

Grupi i vlerësimit të brendshëm për fushën e vlerësimit “Organizimi dhe menaxhimi i institucionit” konstaton se standardet **janë përmbushur plotësisht**. Institucioni dëshmon se funksionon në përputhje me parashikimin e statutit dhe rregulloreve të tij të brendshme. Struktura e brendshme e tij ka autonomi të cilësuar dhe institucioni ka bërë dhe bën përpjekje për internacionalizimin e aktivitetit të tij mësimor dhe shkencor, përmes marrëveshjeve të suksesshme me institucione të tjera, brenda e jashtë vendit. Vendimmarrja është bazuar në organe kolegiale, të ngritura sipas legjislacionit, të cilat garantojnë pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve të institucionit dhe objektivitet e transparencë të vendimmarrjes.

Edhe pse në kuadër të këshillimit dhe planifikimit të karrierës janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm me ngritjen e grupeve të këshilltarëve që vijnë nga terreni, për zhvillimin e mëtejshëm rekomandohet të ngrihen grupe ad-hoc nga përfaqësues të punëdhënësve në cilësinë e ekspertëve për t’i ofruar institucionit “feedback” mbi tregun e punës dhe kërkesave të mundshme.

<sup>51</sup> Evidenca nr.66

## 2. Fusha e vlerësimit: Burimet

### Menaxhimi i burimeve njerëzore

#### **Institucion ndjek një politikë të hapur të punësimit dhe të rekrutimit të burimeve njerëzore.**

Kolegji Universitar “Bedër”, që në fillimet e tij, ka treguar kujdes që të jetë transparent me bërjen publike të mënyrës së organizimit të institucionit, duke publikuar në faqen e internetit organigramën, si edhe duke ia paraqitur atë ministrisë përkatëse, pas çdo ndryshimi që është bërë. Kjo organigramë mund të gjendet në linkun:

(<http://beder.edu.al/sh/content/default/skema-organizative-17-15/4/168>)

KUB ndjek një politikë efikase për punësimin e stafit akademik të kualifikuar, me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme. Politikat dhe strategjia e punësimit përcaktohen në rregulloren e punësimit dhe promovimit të personelit.<sup>52</sup> Rregullorja parashikon hapat e punësimit të stafit akademik të sipërpërmendur, gjë kjo që realizohet përmes një zinxhiri komunikimi formal nga departamenti, në fakultet dhe më pas në rektorat. Kjo praktikë rregullohet edhe përmes procedurës për rekrutimin e stafit.<sup>53</sup> Sipas kësaj procedure, vendet e lira shpallen ne Web-in e institucionit dhe/ose pranë zyrës së punës, sipas lajmërimit të përgatitur nga zyra e burimeve njerëzore, në përputhje me procedurat e ndjekura për punësimin në vendet e lira.<sup>54</sup> Rregullorja përcakton gjithashtu, politikat për nxitjen e stafit, si të atij me kohë të plotë, ashtu edhe të atij me kohë të pjesshme, të ftuar ose me kontratë.

Për një funksionim sa më të suksesshëm, KUB aplikon edhe punësimin e personelit ndihmës mësimor-shkencor, si edhe të atij administrativ. Kjo është një strategji e rëndësishme që institucioni ndjek për promovimin e personelit të ri akademik,<sup>55</sup> të cilët mund të jenë studentë që vazhdojnë studimet në ciklin e dytë apo të tretë, e gjitha kjo me qëllim angazhimit të tyre në të ardhmen në fushën akademike.

KUB i kushton një rëndësi të veçantë përzgjedhjes së personelit akademik, duke vlerësuar fushën e tyre të formimit dhe universitetet nga ku ata vijnë. Fakti që në KUB mbi 55% e stafit ka kualifikim akademik në universitete ndërkombëtare, është një tregues i cilësisë së stafit të rekrutuar nga KUB.

Aktualisht, zyra e burimeve njerëzore, në bashkëpunim me njësitë përkatëse, bazuar në ligjin e ri të arsimit të lartë dhe statutin e ri të KUB, po punon për përditësimin e rregullores dhe procedurës përkatëse.<sup>56</sup>

<sup>52</sup> Evidenca nr.13

<sup>53</sup> Evidenca nr.29

<sup>54</sup> Evidenca nr.61

<sup>55</sup> Evidenca nr.62

<sup>56</sup> Evidenca nr.28

**Institucioni ndjek një politikë integruese të personelit akademik, personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ.**

Me qëllim angazhimit dhe integrimin sa më të shpejtë të personelit të ri, apo edhe atij ekzistues, nën kujdesin e zyrës së burimeve njerëzore dhe rektoratit, KUB në çdo fillim semestri zhvillon një mbledhje me stafin akademik dhe administrativ, për prezantimin e aktivitetit dhe synimeve vjetore apo semestrale që institucioni parashikon të realizojë. Pjesë e rëndësishme e këtyre takimeve janë prezantimi i personelit të ri, ndryshimet e mundshme në planin strategjik etj.

Në kuadër të këshillimit të karrierës për maturantët në shkollat publike apo private, KUB, në periudha të ndryshme të vitit shkollor, organizon takime me personelin, për t'i orientuar ata mbi politikën që institucioni ndjek për rekrutimin e studentëve të rinj, si edhe me ndryshimet legislative që mund të kenë shoqëruar vitin përgjegjës.

Personeli i përditësuar me këtë informacion dhe me praktikën e reja, nën organizimin e dekanatit të studentëve, viziton shkollat e mesme në qytete të ndryshme të vendit, si edhe merr pjesë në panairët e organizuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, apo drejtoritë arsimore rajonale.

Nga ana tjetër, informacioni i përditësuar për çdo vit akademik si për ekipin, po ashtu edhe për studentët ofrohet edhe përmes udhëzuesve për të dyja palët, të emërtuara si Guida e Stafit<sup>57</sup> dhe Guida e Studentit<sup>58</sup>. Këto guida mund të gjenden edhe në faqen e internetit të institucionit.

Gjithashtu, gjatë vitit, në periudha të ndryshme, për personelin akademik, studentët dhe të interesuarit organizohen ditë informimi, ku shpërndahen dhe vihen në dispozicion të tyre broshura të ndryshme, si edhe guida përkatëse.

Institucioni ndjek një politikë favorizuese për personelin e tij, duke e përfshirë atë në të gjitha aktivitetet që KUB organizon, si konferenca, workshope, trajnime të ndryshme etj., të cilat bëhen publike nëpërmjet email-it, faqes zyrtare të institucionit, si dhe rrjeteve sociale.

**Institucioni ndjek një politikë të vlerësimit të aftësive të personelit të tij.**

Zyra e burimeve njerëzore, në bashkëpunim me njësinë e sigurimit të cilësisë, si edhe me njësi të tjera brenda institucionit, ka organizuar një sërë trajnimesh specifike për personelin akademik dhe atë administrativ, të gjitha këto në përputhje me nevojat dhe domosdoshmëritë e stafit. Personeli akademik dhe ai administrativ inkurajohet të shprehë pranë burimeve njerëzore nevojat personale për trajnime në ato fusha që paraqesin interes. Temat e trajnimeve kanë qenë nga më të ndryshmet, si mësimdhënia efektive, përdorimi i teknologjisë bashkëkohore, kërkimi shkencor etj., të cilat janë

<sup>57</sup> Evidenca nr.49

<sup>58</sup> Evidenca nr.50

publikuar edhe në faqen e internetit të Këshillit të Sigurimit të Cilësisë.<sup>59</sup> KUB ka një rregullore të posaçme për vlerësimin e personelit në çdo fund semestri dhe viti akademik. Procedura dhe mënyra e vlerësimit organizohet sipas rregullores mbi anketat dhe vlerësimet, e cila përfshin vlerësimet e studentëve për stafin, vetëvlerësimin e stafit, vlerësimin e eprorëve për vartësit etj.<sup>60 61</sup>

Me qëllim trajnimit dhe formimit të vazhduar të stafit, KUB inkurajon trajnimit e personelit akademik në universitetet brenda dhe jashtë vendit.<sup>62</sup> Për këtë arsye ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh me disa universitete në vende të ndryshme.<sup>6364</sup> KUB ka miratuar udhëzimin mbi nxitjen e publikimeve dhe kërkimit shkencor, ku parashikohen dispozitat mbi përfitimet e personelit, lidhur me trajnimet jashtë vendit.<sup>65</sup>

Duke qenë se KUB gëzon statusin e Kolegjit Universitar, apo më parë “Shkollë e Lartë”, ai nuk mund të promovojë tituj dhe grada shkencore si “Doktor i shkencave”, “Profesor i asociuar” dhe “Profesor”, por mbështet dhe inkurajon të gjithë anëtarët e stafit akademik që të punojnë për të plotësuar të gjitha kriteret dhe të ndjekin procedurat për promovimin e tyre të mëtejshëm akademik.

#### **Institucioni ndjek një politikë të zhvillimit social.**

Duke vlerësuar angazhimin social të personelit si një pjesë të rëndësishme të kontributit në shoqëri, mision ky i rëndësishëm për çdo IAL , KUB ka nxitur përfshirjen e personelit në aktivitete të kësaj natyre. Personeli akademik, në bashkëpunim me studentët e organizuar brenda klubeve studentore, apo edhe në projekte të zbatuara në kuadër të kurseve të caktuara, kanë organizuar një sërë aktiviteteve të kësaj natyre. Ato janë të përmbledhura edhe në raportin vjetor të aktiviteteve, të bëra publike nëpërmjet faqes së internetit dhe të dorëzuara njëkohësisht në MAS.<sup>66</sup> Programe të ngjashme janë ato të organizuara për dhurimin e gjakut, mbledhje të ndihmave financiare për fëmijët e sëmurë me kancer, ofrimi i infrastrukturës teknologjike për mësim në kushtet e shtëpisë për fëmijët e ngujuar në zonën e Shkodrës në Shqipëri etj.

Duke marrë shkas nga realiteti shqiptar një pjesë e rëndësishme e angazhimit të institucionit dhe personelit në nxitjen e dialogut social janë edhe aktivitetet e shumta të organizuara me komunitete të ndryshme fetare, si dhe me shkolla që ofrojnë edukim fetar. Në këtë kuadër janë organizuar disa takime pune dhe workshope, ku kanë marrë pjesë anëtarë të personelit dhe studentë nga këto

<sup>59</sup> Shih: <http://qac.beder.edu.al/pages.php?s=14>

<sup>60</sup> Evidenca nr.52

<sup>61</sup> Evidenca nr.10

<sup>62</sup> Evidenca nr.79

<sup>63</sup> Evidenca nr.92

<sup>64</sup> Evidenca nr.78

<sup>65</sup> Evidenca nr.23

<sup>66</sup> Evidenca nr.58

shkolla.<sup>67</sup>

Nga ana tjetër, për t'u ardhur në ndihmë studentëve dhe anëtarëve të personelit, KUB ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione shëndetësore (Spitali Amerikan), të cilat ofrojnë lehtësira në drejtime të ndryshme për ta, si edhe ka punësuar një mjek të posaçëm që angazhohet gjatë procesit mësimor.

Në kuadër të politikës së tij mbi sigurimin e jetës dhe shëndetit të personelit dhe studentëve, KUB, me vendim Senati, ka ngritur edhe këshillin e sigurisë dhe shëndetit në punë.<sup>68</sup>

Gjithashtu, KUB ka kontraktuar kompani private të sigurisë<sup>69</sup>, të cilat garantojnë sigurinë e ambientit për 24 orë gjatë gjithë javës.

#### **Institucioni siguron menaxhimin efikas të burimeve njerëzore.**

Me qëllim menaxhimin efikas të aktivitetit, KUB, përmes rregullores së organizimit akademik<sup>70</sup> dhe rregullores së organizimit administrativ<sup>71</sup> të institucionit, ka përcaktuar qartë funksionet dhe detyrat e organeve akademike dhe administrative. Gjithashtu, institucioni ka hartuar për çdo pozicion pune përshkrimet e punës, të cilat bëhen të ditura në njoftimin për vendin vakant, si edhe në momentin e punësimit. Personeli akademik në aneksin përkatës të kontratës së punës<sup>72</sup> ka në mënyrë përshkruese detyrat e veta.<sup>73</sup>

#### **Menaxhimi financiar**

##### **Institucioni harton buxhetin, në përputhje me procedurat e përcaktuara.**

KUB gëzon status jofitimprurës dhe jopublik. Në ndjekjen e standardeve të programimit buxhetor dhe menaxhimit financiar, institucioni ka vendosur standardet e tij të brendshme. Projektbuxheti i KUB hartohet nga zyra e financës në bashkëpunim me kancelarin e institucionit, i dërgohet për miratim Këshillit të Administrimit dhe më pas i përcillet për miratim Këshillit të Lartë. Kjo procedurë parashikohet në statutin e institucionit, ku përshkruhen kompetencat e Këshillit të Lartë dhe kompetencat e Këshillit të Administrimit të institucionit.

Aktualisht, në përputhje me ndryshimet e fundit ligjore, njësia bazë harton projektbuxhetin e saj dhe e dërgon për miratim në njësinë kryesore. Pasi diskutohet te kjo e fundit, me nënshkrimin e dekanit respektiv i përcillet rektoratit për aprovim dhe në fund miratohet nga këshilli i lartë (Bordi i administrimit)<sup>74</sup>.

<sup>67</sup> Evidenca nr.106

<sup>68</sup> Evidenca nr.40

<sup>69</sup> Evidenca nr.97

<sup>70</sup> Evidenca nr.4

<sup>71</sup> Evidenca nr.5

<sup>72</sup> Evidenca nr.53

<sup>73</sup> Evidenca nr.80

<sup>74</sup> Evidenca nr.60

**Institucioni siguron mjetet e nevojshme për të zbatuar politikën financiare.**

Shpërndarja e burimeve financiare bëhet sipas një buxheti paraprak të miratuar dhe pranuar nga të gjitha njësitë. Institucioni respekton standardet kombëtare të kontabilitetit dhe mirëmban regjistrimet e tij në përputhje me ligjin për “kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. KUB është institucion jopublik i arsimit të lartë dhe rregullat e administrimit të brendshëm përcaktohen sipas akteve të miratuara nga vetë institucioni konform edhe akteve ligjore në fuqi. Mënyra e ndarjes dhe ndjekjes së buxhetit parashikohet në statutin e institucionit.<sup>75</sup>

**Institucioni ndjek një politikë të kontrollit buxhetor dhe financiar.**

Duke qenë se KUB është institucion jopublik dhe jofitimprurës, ai nuk është objekt i drejtpërdrejtë i auditimit financiar nga agjencitë shtetërore. Megjithatë, KUB i paraqet çdo fundviti Ministrisë së Arsimit dhe Sportit raportin vjetor institucional, ku përfshihet edhe buxheti i vitit të kaluar dhe një projektbuxhet i vitit të ardhshëm akademik.<sup>76</sup>

Nga ana tjetër, këshilli i lartë, krahas miratimit përfundimtar të buxhetit, përcakton mënyrat e shpenzimeve dhe kontrollon zbatimin e tij dhe të planit të investimeve, si edhe çdo veprimtari tjetër financiare.<sup>77</sup>

Për vitet në vijim, nisur nga detyrimet e ligjit nr.80/2015, KUB do të përfshijë në veprimtarinë e tij edhe auditimet financiare për aktivitetet që do të zhvillojë.

**Menaxhimi i sistemeve të informacionit**

**Institucioni disponon një sistem informimi**

Sistemi i informimit dhe menaxhimit të informacionit realizohet përmes dy njësi administrative, zyra e marrëdhënieve me publikun dhe median dhe zyra e teknologjisë së informacionit. Detyrat e tyre parashikohen në rregulloren për organizimin administrativ<sup>78</sup>.

Këto zyra koordinohen me njëra-tjetrën si për publikimin e informacioneve të ndryshme, ashtu edhe për ndërtimin e infrastrukturës teknike dhe teknologjike, si faqet e internetit, profilet në rrjetet sociale etj.

Në mbështetje të të gjithë këtij procesi, KUB ka mundësuar për studentët dhe personelin edhe Sistemin e Menaxhimit të Informacionit (BIS – Beder Information System)<sup>79</sup>. BIS siguron transparencë dhe objektivitet në lidhje me mënyrën e organizimit të proceseve mësimore që lidhen me lëndët, regjistrimin e studentëve dhe vlerësimin e tyre. Ky sistem i lejon studentit dhe personelit që të sigurojë informacion rreth procesit mësimor akademik dhe administrativ. Studentët dhe personeli kanë mundësi që përmes fjalëkalimeve dhe adresave individuale, të ofruara nga institucioni, të përditësohen me çdo informacion.

<sup>75</sup> Evidenca nr.1: Neni.12, 15, 23; Evidenca nr.2: Neni 54, 95

<sup>76</sup> Evidenca nr.57: faqe 62,63

<sup>77</sup> Evidenca nr.1: Neni 12. Pika 5.

<sup>78</sup> Evidenca nr.5: Neni 34, 39

<sup>79</sup> Shi: bis.beder.edu.al



KUB publikon në faqen e tij të internetit [www.beder.edu.al](http://www.beder.edu.al) të dhënat e nevojshme në lidhje me programet e ofruara, ofertën akademike, ndërtimin dhe funksionimin e institucionit, si edhe statutin dhe rregulloret e funksionimit të tij. Zyra e teknologjisë së informacionit krijon, trajton, mirëmban dhe siguron vazhdimësinë e procesimit të të dhënave të institucionit përmes sistemit të automatizuar dhe ndihmon në mësimdhënie, kërkime dhe aktivitete administrative.

Gjithashtu, zyra e marrëdhënieve me publikun dhe median organizon përgatitjen dhe prodhimin e të gjitha materialeve prezantuese, publikimin e informacionit në Web dhe në sistemin e teknologjisë së informacionit dhe përditësimin e tij.

### **Institucioni bashkërendon veprimtaritë në fushën e teknologjisë së informacionit.**

Infrastruktura teknike dhe teknologjike e institucionit mundëson një proces efektiv mësimdhënës dhe mësimnxënës. Çdo anëtar i personelit është i pajisur me një zyrë që garanton kushtet e nevojshme të punës, duke u pajisur me kompjuter, lidhje interneti, adresa të posaçme emaili, telefon zyre, raftë për mbajtjen e dokumentacionit etj.

Kjo teknologji është e pranishme edhe në të gjitha sallat ku zhvillohen leksionet, ku përveç kompjuterit dhe internetit, në to janë montuar edhe tabelat elektronike (Smart Board).

Gjithashtu, institucioni, varësisht nevojave të departamenteve ka vënë në dispozicion edhe laboratorin e kompjuterave, redaksinë e informacionit të pajisur me teknologjinë përkatëse etj..

KUB ka në funksionim sallën e konferencave të pajisur me mjetet e nevojshme teknologjike, përfshirë mundësimin e përkthimit simultan, brown box, sallën e senatit etj. Këto janë të pajisura me mjetet teknologjike që mundësojnë zhvillimin e aktiviteteve, përfshirë organizimin e videokonferencave, mbrojtje të tezave etj.<sup>80</sup>

### **Institucioni menaxhon pasuritë e paluajtshme**

Aktualisht, KUB vazhdon aktivitetin e tij në mjedise të kontraktuara me qira, për një periudhë dhjetëvjeçare.<sup>81</sup> Nga ana tjetër, KUB ka nisur ndërtimin e kampusit të ri universitar, i cili në përfundim do të garantojë kushte bashkëkohore për aktivitetin akademik. Varësisht protokollit të nënshkruar midis Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe Fondacionit Arsimor “Sema”, KUB posedon pronësinë e truallit për ndërtimin e kampusit.<sup>82</sup>

<sup>80</sup> Evidenca nr.89

<sup>81</sup> Evidenca nr.103; Evidenca nr.96

<sup>82</sup> Evidenca nr.95

**Institucioni siguron ruajtjen, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë së tij akademike, kulturore dhe shkencore.**

Kolegji Universitar “Bedër” organizon çdo vit mesatarisht mbi pesë konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, në përfundim të të cilave publikohen edhe librat e referimeve, të identifikuara me kodin ISBN, të lëshuar nga Biblioteka Kombëtare. Në kuadër të ruajtjes së trashëgimisë akademike, kulturore dhe shkencore, kolegji ka dorëzuar pranë Bibliotekës Kombëtare nga pesë kopje për çdo botim të realizuar. Bazuar në misionin e KUB, i cili vlerëson mbështetjen e kërkimit shkencor, me qëllim vënie në jetë të ideve dhe projekteve, të cilat ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe të mbarë shoqërisë, kolegji, përmes udhëzimit “Mbi nxitjen e publikimeve dhe kërkimit shkencor”, mbështet pjesëmarrjen në aktivitete shkencore dhe angazhimin në projekte kërkimore, si dhe shpërblen arritjet akademike vjetore mbi indikatorë transparentë të parashikuar në udhëzimin përkatës<sup>83</sup>.

Nga ana tjetër, rregullorja e arkivës përcakton rregullat bazë për organizimin e funksionimin e shërbimit arkivor në KUB për të gjitha dokumentet e krijuara nga organet drejtuese, njësitë kryesore, njësitë bazë dhe njësitë administrative ndër vite.<sup>84</sup>

**Institucioni ndjek një politikë të menaxhimit të aseteve të tij**

Për një menaxhim sa më efektiv të aseteve infrastrukturore të institucionit, zyra e shërbimeve administrative është përgjegjëse për përdorimin dhe zhvillimin në mënyrën e duhur të hapësirave dhe kapaciteteve fizike të disponueshme.<sup>85</sup>

E cituar edhe më sipër, KUB ka një infrastrukturë të përshtatshme dhe bashkëkohore për zhvillimin e aktivitetit të tij. Mjediset janë të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme, si: smart board, kompjuter, video-projektorë, mundësi kondicionimi, ndriçim natyral të mjaftueshëm, ndërsa ambientet e tjera, si: salla e konferencës, biblioteka etj., ndihmojnë në zhvillimin maksimal të mësimdhënies.

Gjithashtu, KUB vë në dispozicion mjedise për veprimtaritë e personelit akademik, në përpjesëtim me numrin e tij. Çdo anëtar i personelit akademik ka zyrën, tavolinën, kompjuterin, mjetet e nevojshme kancelarike për realizimin e detyrave të tij.<sup>86</sup>

**Institucioni ngre një strukturë logjistike administrative për kryerjen e funksioneve me interes të përbashkët**

KUB vlerëson shërbimet logjistike duke realizuar çdo vit një anketë, e cila i drejtohet personelit akademik, administrativ dhe studentëve, në lidhje me cilësinë e shërbimeve që ofron KUB dhe çfarë duhet të përmirësojnë.<sup>87</sup>

<sup>83</sup> Evidenca nr.65

<sup>84</sup> Evidenca nr.12

<sup>85</sup> Evidenca nr.5: Neni 37

<sup>86</sup> Evidenca nr.107

<sup>87</sup> Evidenca nr.81



Gjithashtu, institucioni, që nga krijimi i tij, ka ngritur zyrën e çështjeve administrative, e cila është përgjegjëse për përdorimin dhe zhvillimin në mënyrën e duhur të hapësirave dhe mundësive fizike që disponon KUB dhe sigurinë e saj.<sup>88</sup>

Në kuadër të bashkëpunimit me palë të treta, si edhe në funksion të nevojave të tregut, KUB ka ofruar ambientet e tij për zhvillimin e provimeve të gjuhës angleze, si TOEFL, APTIS etj.<sup>89</sup>

### **Menaxhimi i veprimtarisë së institucionit**

#### **Institucioni siguron mjedise dhe infrastrukturë të përshtatshme për veprimtarinë akademiko-shkencore.**

KUB vazhdon aktivitetin e tij në dy godina të kontraktuara me qira për një periudhë dhjetëvjeçare, me sipërfaqe në total 5628 m<sup>2</sup>. Infrastruktura e përdorur plotëson kriteret e përcaktuara në pikën 4 të shtojcës nr.3 të udhëzimit të MASH, nr.11, datë 28.02.2011 “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit” që duhet të paraqesë subjekti juridik, për hapjen e një institucioni privat të arsimit të lartë, ose programeve të studimit, në ciklin e parë dhe të dytë të studimit.<sup>90</sup>

Godina A, 8 kate - me një sipërfaqe totale të shfrytëzueshme prej 3957 m<sup>2</sup>, ku zhvillojnë kryesisht mësimin sipas orareve të përcaktuara departamentet e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Fakultetit të Filologjisë dhe Edukimit. Godina B, 2 kate – me një sipërfaqe totale të shfrytëzueshme prej 1671 m<sup>2</sup>, ku zhvillojnë kryesisht mësimin sipas orareve të përcaktuara departamentet e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Fakultetit të Filologjisë dhe Edukimit. Godinat kanë një infrastrukturë moderne dhe janë të pajisura me kondicionerë. Klasat janë të pajisura me videoprojektorë dhe me tabela inteligjente të cilat bëjnë të mundur zhvillimin normal të procesit mësimor.

Në godinën A, përveç klasave të mësimin, ndodhet edhe muzeu i medias, biblioteka që ka shërbim klasik dhe dixhital dhe ambiente çlodhëse për studentët, si mensë, mjedise për këshillin studentor, për klubet studentore, si dhe mjedise të shërbimit shëndetësor (mjekësor).

Në godinën B, krahas klasave dhe zyrave, ndodhen ambiente për veprimtari të planifikimit të karrierës dhe aktiviteteve ekstrakurrikulare, siç janë salla e gjyqit apo Brown Box. Gjithashtu është prezent ambienti i palestrës ku studentët dhe stafi mund ta shfrytëzojnë për aktivitete individuale sportive.

Godinat e mësipërme janë të pajisura me certifikatat përkatëse të pronësisë dhe disponojnë vërtetimet përkatëse për mbrojtjen kundër zjarrit dhe lejen higjieno-sanitare, sipas përcaktimeve ligjore.<sup>91</sup>

Sipas numrit të studentëve që aktualisht ndjekin studimet në IAL, institucioni ofron mesatarisht 7.6 m<sup>2</sup>/student dhe 1 boks/19 studentë.

<sup>88</sup> Evidenca nr.5: Neni 37

<sup>89</sup> Evidenca nr.100

<sup>90</sup> Evidenca nr.96

<sup>91</sup> Evidenca nr.93, Evidenca nr.94

KUB disponon në total 39 bokse hidro-sanitare për studentët dhe stafin akademik e administrativ. Duke iu referuar numrit të studentëve, institucioni ynë plotëson normativën për nyjet hidro-sanitare të parashikuara në udhëzimet respektive.

KUB ka vënë në dispozicion për mësimdhënie objekte të ndërtuara (ose rindërtuara) me materiale cilësore bashkëkohore dhe që plotësojnë kushtet higjieno-sanitare për studentët dhe personelin akademik e administrativ, duke shmangur elementet e rrezikshmërisë.

KUB plotëson normativat teknike të ndriçimit natyral, sipërfaqja e dritareve mbulon me ndriçim, minimalisht 15 – 20% të sipërfaqes së dyshemesë i cili është i orientuar nga krahu i majtë i studentit, mundësisht nga juglindja. Kjo gjë vërtetohet nga planimetria e ndërtesës së bashkëngjitur. Ka dalje dhe shkallë emergjence. Kjo gjë vërtetohet nga raporti i zjarrfikësve, i bashkëngjitur. KUB ka sistemin e mbrojtjes kundra zjarrit dhe sistemin e mbrojtjes kundër shkarkesave atmosferike. Kjo gjë vërtetohet nga raporti i zjarrfikësve, i bashkëngjitur. KUB ka funksional sistemin e ngrohjes. Kjo gjë vërtetohet dhe në relacionin teknik të bashkëngjitur. KUB ka burime alternative për furnizimin me energji elektrike (motogjenerator etj.), si edhe rezerva të mjaftueshme të ujit të përdorshëm (depozita uji). Kjo gjë vërtetohet dhe në relacionin teknik.<sup>92</sup>

**Institucioni disponon dokumentacion të plotë të veprimtarisë akademike në letër (hardcopy) dhe në formë elektronike**

Me qëllim ruajtjen e veprimtarisë akademike dhe administrative, KUB ka një rregullore të posaçme për arkivimin dhe menaxhimin e dokumentacionit.<sup>93</sup> Institucioni ka përcaktuar mjedise të posaçme për arkivimin e dokumentacionit në letër.

Çdo punonjës është i pajisur me kompjuter personal, por në fund të çdo viti të dhënat kalohen në një memorie digjitale të jashtme (hard disc). Çdo zyrë në KUB nxjerr statistika, për të cilat është e ngarkuar. Këto statistika dorëzohen në rektorat. Sekretaria mësimore në KUB është përgjegjëse për ruajtjen dhe arkivimin e të dhënave për regjistrimin e studentëve, numrin e matrikullimit etj., në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, si dhe rregulloren e zyrës së sekretarisë mësimore.<sup>94</sup>

Në lidhje me kurrikulat mësimore, brenda institucionit ekziston zyra e zhvillimit të kurrikulave, e cila drejton zhvillimin e procesit kurrikular për të gjitha programet e reja dhe ekzistuese. Gjithashtu, kurrikulat e çdo programi bëhen publike edhe përmes faqeve në internet të çdo departamenti.

Institucioni disponon një regjistër të studentëve (në formë të shkruar dhe elektronike që mbahet në ruajtje të përhershme), me vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit, të dhëna për diplomën ose diplomat e

<sup>92</sup> Evidenca nr.93; Evidenca nr.94; Evidenca nr.96

<sup>93</sup> Evidenca nr.12

<sup>94</sup> Evidenca nr.14

marra, bashkë me suplementin e diplomës, numrin e matrikullimit etj., të gjitha këto në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Sekretaria mësimore është përgjegjëse për plotësimin dhe ruajtjen e regjistrit në fjalë.

### **Përfundimet dhe vlerësimi**

Grupi i vlerësimit të brendshëm vlerëson se për fushën e vlerësimit “Burimet” standardet janë **përbushur plotësisht**.

Institucioni, nëpërmjet rregulloreve përkatëse, ka përcaktuar qartë funksionet dhe detyrat e organeve akademike dhe administrative, si dhe përshtatjet e punës për çdo pozicion. Kjo gjë siguron menaxhimin efikas të aktivitetit të tij. Institucioni ndjek politika efektive për punësimin, vlerësimin dhe promovimin e personelit, praktikë kjo që ka ndihmuar në sigurimin e punësimit të një personeli të kualifikuar akademik e administrativ. Institucioni ndjek dhe zhvillon në mënyrë të vazhdueshme politikën për mbështetjen e personelit me programe të trajnimit dhe të formimit të vazhduar.

Institucioni ka një sistem të mirorganizuar dhe efektiv të informimit, i cili u mundëson studentëve dhe personelit të sigurojnë informacion të plotë rreth procesit akademik dhe administrativ. Ky sistem mbështetet në një infrastrukturë bashkëkohore, që përfshin edhe Sistemin e Informimit (BIS – Bedër Informatizon Sistem)<sup>95</sup>.

Institucioni ka siguruar mjedise dhe infrastrukturë të përshtatshme për organizimin e veprimtarisë akademiko-shkencore dhe mbetet i angazhuar për ndjekjen dhe përmirësimin e tyre. Nga ana tjetër, institucioni në perspektivë do të zhvendoset në mjediset e reja të kampusit universitar, gjë që do t'i sjellë një menaxhim dhe kushte akoma më cilësore në këtë drejtim.

Institucioni siguron ruajtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë së tij akademike, kulturore dhe shkencore, nëpërmjet njësive përkatëse dhe ka në dispozicion dokumentacion të plotë të veprimtarisë akademike në letër (hardcopy) dhe në formë elektronike.

Nisur nga statusi jofitimprurës që institucioni gëzon, buxheti dhe shpërndarja e tij bëhen përmes procedurave transparente dhe të mirëpërcaktuara. Ky buxhet është i detajuar dhe i deleguar deri në njësinë bazë.

Edhe pse institucioni në të gjitha njësitë dhe programet ka ekip administrativ dhe akademik që përbush kriteret e përcaktuara në legjislacion, duke qenë se në disa fusha planifikohen zgjerimi me programe të reja inovative ndihet e nevojshme rekrutimi i disa anëtarëve të rinj, të profilizuar në fusha konkrete për të cilat departamentet do të kenë nevojë.

<sup>95</sup> Evidenca nr.108

### 3. Fusha e vlerësimit: Kurrikula

#### Programet e studimeve të ofruara

##### **Institucioni ofron programe, në përputhje me misionin dhe kushtet e infrastrukturës së tij**

Me anë të transparencës përmes faqes së internetit, por edhe të materialeve të ndryshme mbështetëse, si: broshura, guida, pjesëmarrje në panairë, prezantim nëpër shkolla, ditët e hapura etj., KUB siguron mundësinë që programet e studimit të njihen nga publiku.

Nisur edhe nga udhëzimet e mbërritura nga MAS dhe DAR-et, KUB zhvillon takimet me drejtuesit e shkollave të mesme në të gjithë vendin. Për këtë arsye, pranë KUB funksionon edhe zyra e përzgjedhjes dhe pranimit të studentëve.<sup>96</sup>

KUB, që në fillimet e tij, i ka qëndruar besnik misionit që ka pasur, duke ofruar programe akademike që i përkasin vetëm një fushe të caktuar. KUB, ka përcaktuar programet e studimeve parësore që ofron dhe me të cilat ka vendosur të krijojë profilin e tij. Që në kërkesën fillestare të drejtuar institucioneve shtetërore për nisje të aktivitetit, KUB ka përcaktuar fushën e shkencave sociale dhe humane si parësore në ndërtimin e profilit institucional. E shprehur më konkretisht, programet akademike të ofruara janë të ndara në dy fakultete dhe gjashtë departamente, të cilat mbështesin edhe profilin e sipërpërmendur.<sup>97</sup>

E përmendur edhe më sipër, KUB ofron programe studimi në dy cikle, të parë dhe të dytë.

Këto programe studimi, varësisht edhe punës së zyrës së zhvillimit të kurrikulës, janë organizuar në mënyrë të tillë që të harmonizojnë të gjitha komponentët e përcaktuar në udhëzimet përkatëse.<sup>98</sup>

Në lidhje me mënyrën, vlerësimin e aftësive të studentëve, KUB ka rregulloret për studimet e ciklit të parë dhe provimet<sup>99</sup>, si edhe ato për studimet e ciklit të dytë<sup>100</sup>, të miratuara nga Senati Akademik dhe Këshilli i Lartë.

##### **Formimi i vazhdueshëm është pjesë integrale e programeve të studimeve**

Duke u bazuar në Deklaratën e Bolonjës, nevojat e tregut në vend, rajon dhe më gjerë, Kolegji Universitar “Bedër” nxit frymën e formimit të vazhdueshëm. Në këtë kuadër, KUB ofron një sërë metodash dhe modulesh që synojnë formimin e vazhdueshëm të stafit dhe zhvillimin e mëtejshëm individual dhe mosshkëputjen nga mjedisi arsimor. Për këtë arsye, pranë KUB është ngritur zyra e planifikimit të karrierës, në kuadër të së cilës janë

<sup>96</sup> Evidenca nr.5: Neni 32

<sup>97</sup> Evidenca nr.87

<sup>98</sup> Evidenca nr.87

<sup>99</sup> Evidenca nr.6

<sup>100</sup> Evidenca nr.7

organizuar një sërë praktika (internshipe) etj. Veprimtaria dhe organizimi i zyrës kryhet në bazë të dispozitave të parashikuara në rregulloren mbi organizimin administrativ. Formimi i vazhdueshëm është një çështje, të cilës i jepet prioritet edhe në planin strategjik, ku parashikohen përparësitë për përmirësimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të saj.<sup>101</sup>

**Programet e studimeve ofrohen në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit**

Në përmbushje të misionit të tij, KUB ofron programe studimi në përputhje të plotë me të gjithë komponentët e strategjisë për zhvillimin e institucionit. Plani strategjik i institucionit është planifikuar, duke marrë parasysh tri elemente të rëndësishme, një ndër të cilët është mësimdhënia, e parashikuar kjo në mënyrë të detajuar në kapitullin V të këtij plani.<sup>102</sup> Në përmbushje të këtij kriteri, KUB ofron informacion të detajuar, të vazhdueshëm dhe të përditësuar për të gjithë kandidatët e interesuar për të vazhduar studimet në këtë institucion, si edhe për ata që janë studentë dhe që vijojnë studimet në të.

Guida e studentëve, me të cilën ata pajisen në momentin e regjistrimit, ofron ndihmë teorike dhe praktike për veprimet, me të cilat studentët përballen gjatë studimeve universitare<sup>103</sup>. Informacion më i detajuar jepet edhe në faqet e internetit të çdo departamenti.<sup>104</sup>

Informacioni, në lidhje me emërtimin e diplomës dhe suplementin e saj, i prezantohet studentit përmes guidës së studentit, kontratës që nënshkruan, faqes së internetit të programit përkatës dhe përmes takimeve të zhvilluara në kuadër të mbështetjes së institucionit.

**Programet e studimeve ofrohen në përputhje me objektivat kombëtarë dhe ndërkombëtarë.**

Duke synuar ruajtjen e cilësisë dhe efikasitetin në menaxhim, KUB e ka përqendruar aktivitetin e tij vetëm në kampusin qendror në Tiranë. Politikat e KUB janë hartuar në kuadër të politikave kombëtare, të parashikuara në planin strategjik për arsimin e lartë të Ministrisë së Arsimit dhe të Sportit. KUB synon promovimin e kulturës dhe të traditës shqiptare, ndërkohë që nxit larminë kulturore.

Në këtë kuadër, KUB ka nxitur pranimin e studentëve nga disa vende të ndryshme (16 vende) duke ofruar disa programe në gjuhë të huaja, si p.sh. gjuhë dhe letërsi angleze, gjuhë dhe letërsi turke, shkenca islame, edukim etj.

Për të promovuar mësimin e gjuhëve të huaja, përveç ngarkesës mësimore që përfshihet në kurrikulat e programeve, KUB mundëson edhe ofrimin e zbritjeve nga tarifat e studimit deri në 100% për studentët që janë të

<sup>101</sup> Evidenca nr.67

<sup>102</sup> Evidenca nr.33: Kapitulli V

<sup>103</sup> Evidenca nr.50

<sup>104</sup> Shih: <http://law.beder.edu.al>



suksesshëm në provimet ndërkombëtare në TOEFL dhe SAT.<sup>105</sup>

**Programet e studimeve ofrohen në përputhje me kapacitetet e institucionit.**

Ngarkesa mësimore e pedagogëve caktohet në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi. Kriteret e përlogaritjes së ngarkesës mësimore të personelit akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, të angazhuar në mësimdhënie në programet e ciklit të parë e të dytë, parashikohen në udhëzimin për ngarkesën mësimore të institucionit.<sup>106</sup> Ky udhëzim, organizon një harmonizim efektiv midis ngarkesës së mësimdhënies dhe angazhimeve të tjera.

I njëjti udhëzim parashikon edhe mënyrën e pagesës së orëve shtesë dhe kufijtë e lejuar të ngarkesës mbi normë të pedagogëve.

**Programet e studimeve janë lehtësisht të kuptueshme dhe objektivat e tyre janë të përcaktuara qartë.**

Përmbajtja e programeve të studimeve, të kurrikulës, të programeve mësimore (syllabuseve) etj. janë në dispozicion të studentëve dhe sigurohen lehtë prej tyre nëpërmjet faqes Web të institucionit. Në orën e parë të mësimit, pedagogu i lëndës shpërndan te studentët syllabusin e lëndës dhe i informon ata me detajet e zhvillimit dhe të vlerësimit të saj.

Objektivat e programeve të studimeve janë të përcaktuara në dosjet e dorëzuara në MASH në momentin e licencimit dhe janë të bëra publike nëpërmjet faqes së internetit të çdo departamenti.

Gjithashtu, detajet e mësipërme janë të përcaktuara dhe në rregulloret përkatëse të studimeve.<sup>107</sup>

KUB ka përcaktuar qartë kriteret e pranimit të studentëve. Ato përfshihen në rregulloren themelore, si dhe në rregulloren e studimeve “Bachelor” dhe të provimeve. Me ndryshimet e reja ligjore, kriteret e pranimit të studentëve propozohen nga departamentet përkatëse dhe miratohen nga senati.<sup>108</sup>

**Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen e studentëve me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme.**

Nisur nga harmonizimi i lëndëve që përbëjnë kurrikulat e programeve “Bachelor” dhe “Master”, ato lejojnë një kalim progresiv nga njëri cikël te tjetri. Kompetencat e parashikuara si në përmbajtjen e programit pararendës dhe të lëndëve që ai përmban, vijojnë më tej me një lidhje përmbajtësore dhe formuese për vazhdimin e ciklit pasardhës në fushën përgjegjëse.

Bazuar në ndarjen që Karta e Bolonjës përcakton dhe udhëzimeve përkatëse për ndarjen e natyrshme të lëndëve në kurrikulën e programit “Bachelor” sipas grupeve A, B, C, D, E dhe F, programet e studimeve të ciklit të parë i

<sup>105</sup> Evidenca nr.18

<sup>106</sup> Evidenca nr.25

<sup>107</sup> Evidenca nr.19

<sup>108</sup> Evidenca nr.63

pajisin studentët me njohuritë bazë, mbi metoda e parime të përgjithshme shkencore dhe formimin e shprehive të veçanta.

E parashikuar në rregulloren mbi studimet dhe provimet e ciklit të parë, në nenet 4, 9, 16, 33, si dhe në rregulloren e transferimeve, në KUB studentët informohen dhe orientohen në lidhje me mundësinë e transferimit të programeve të studimeve apo të krediteve të fituara gjatë zhvillimit të tyre.<sup>109</sup>

Programet e studimeve të këtij cikli hartohen në përputhje me kërkesat e tregut dhe legjislacionin në fuqi, në mënyrë të tillë që studentët që përfundojnë ciklin e parë të kenë mundësi për punësim, të cilat janë të përcaktuara dhe në programin e çdo departamenti.<sup>110</sup>

**Programet e studimeve të ciklit të parë hartohen në mënyrë të tillë që të lehtësohet ambientimi i studentit me mjedisin universitar.**

Institucioni ndjek politika mbështetëse për të siguruar mbarëvajtjen e studentëve dhe ambientimin e tyre me mjedisin universitar. Për këtë arsye, është themeluar edhe dekanati i studentëve (Drejtoria e marrëdhënieve me studentët), ku një ndër funksionet e tij është këshillimi psikologjik dhe administrativ për studentët. Çdo departament ka caktuar një person përgjegjës për këshillimin e karrierës, që mblidhen nën koordinimin e dekanit të studentëve. Nën kujdesin e dekanatit të studentëve, dy ditët e para të çdo viti akademik i kushtohen orientimit të studentëve të rinj, në lidhje me mundësitë që institucioni ofron.<sup>111</sup>

Gjithashtu, çdo departament emëron një këshilltar akademik për një grup të caktuar studentësh, i cili ndihmon në mbarëvajtjen e çështjeve mësimore<sup>112</sup>. Kjo parashikohet në rregulloren e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë.

Institucioni ka të shprehur në statut dhe në rregullore parimet e lirisë akademike, e cila, përveç të tjerash, përkthehet edhe në liri të metodave të ndryshme të mësimdhënies. Institucioni inkurajon metoda sa më të larmishme të mësimdhënies, me një qëllim të vetëm: arritjen e përsosmërisë në mësimdhënie, çka do të shërbejë që të kemi një cilësi dhe një nivel sa më të lartë të të nxëniet të studentët.

KUB merr në punë me përparësi personelin akademik që angazhohet në veprimtari kërkimore-shkencore. KUB i kushton një rëndësi të veçantë përzgjedhjes së stafit akademik, duke synuar përputhjen e interesave të tyre me programet që ofrohen.

Duke plotësuar të gjitha standardet e parashikuara në legjislacionin shqiptar, në lidhje me numrin e stafit akademik për çdo departament, KUB ka punësuar edhe personel me kohë të pjesshme, i cili angazhohet në disa

<sup>109</sup> Evidenca nr.15

<sup>110</sup> Evidenca nr.84

<sup>111</sup> Shih: <https://www.beder.edu.al/sh/gallery/default/>

<sup>112</sup> Evidenca nr.55

fusha specifike. Aktualisht institucioni mbi 83 % të programeve i mbulon nga personeli me kohë të plotë.<sup>113</sup> Kjo përqindje ndryshon sipas programeve të studimit, varësisht specifikeve që kanë fushat përkatëse.

**Programet e studimeve të ciklit të dytë mbështeten mbi kërkimin dhe, për realizimin e tyre, institucioni bashkëpunon me aktorë të fushës ekonomike.**

Pedagogët që angazhohen në veprimtari kërkimore-shkencore përbëjnë pjesën më të madhe të ekipit akademik. Gjatë viteve akademike numri i botimeve nga ekipi akademik efektiv është rritur në mënyrë të vazhdueshme.<sup>114</sup>

Po i njëjti ekip është i angazhuar në departament dhe luan rol aktiv në hartimin dhe zbatimin e programeve të studimeve. Programet e studimeve “Master i shkencave” janë hartuar në mbështetje të politikave kërkimore të Kolegjit Universitar “Bedër”.

KUB u kushton rëndësi të veçantë praktikave profesionale. Në këtë kontekst, gjatë verës, studentët nxiten dhe u ofrohet të ndjekin praktika mësimore në formë stazhi. Gjatë vitit akademik 2015-2016, 74 studentë kanë kryer stazhin veror në Shqipëri dhe jashtë vendit. Për të lehtësuar gjetjen e vendeve të praktikave për studentët, KUB ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me kompani të sektorit privat në Shqipëri, në Turqi etj.<sup>115</sup>

Falë ngritjes së zyrës së të diplomuarve (Alumni) dhe planifikimit të karrierës në dekanatin e studentëve, është ndjekur edhe vijueshmëria e punësimit të studentëve pas përfundimit të studimeve.<sup>116</sup>

Në lidhje me programet “Master profesional”, KUB angazhon në mësimdhënie përfaqësues nga fusha përgjegjëse.

Duke plotësuar të gjitha standardet e parashikuara në legjislacionin shqiptar në lidhje me numrin e personelit akademik për çdo departament, KUB ka punësuar edhe personel me kohë të pjesshme, i cili angazhohet në disa fusha të veçanta.

Nga ana tjetër, përqindja e programeve të mbuluara nga personeli me kohë të plotë është rritur në mënyrë të ndjeshme këto vite akademike, duke tejkaluar 83 %, madje disa programe e realizojnë ngarkesën mësimore 100% me staf të brendshëm.<sup>117</sup>

<sup>113</sup> Evidenca nr.77

<sup>114</sup> Evidenca nr.86

<sup>115</sup> Evidenca nr.92

<sup>116</sup> Evidenca nr.85

<sup>117</sup> Evidenca nr.77



**Programet e studimeve synojnë të nxisin mobilitetin e studentëve shqiptarë në Europë dhe më gjerë.**

Programet e studimeve ofrohen në përputhje me Procesin e Bolonjës në cikle të njëpasnjëshme, sipas sistemit “Bachelor” dhe “Master”.

Mënyra e organizimit të programeve mësimore lejon transparencë dhe lehtësi për t’i kuptuar ato, pasi strukturimi i tyre bëhet varësisht kritereve të përcaktuara nga Karta e Bolonjës. Programet janë të detajuara dhe të vlerësuara në kredite europiane, sipas “Sistemit europian të transferimit dhe grumbullimit të krediteve (ECTS)”. E gjithë përmbajtja e programeve është e arritshme përmes faqes së internetit si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në atë angleze.

Diplomat, që jepen në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë, shoqërohen me suplementin/shtojcën e diplomës.<sup>118</sup>

Gjuha e huaj është një ndër kriteret për pranim në disa programe “Bachelor”. Ndërkohë, në programet “Master” ajo është kusht gjë që ndihmon dhe lehtëson mobilitetin e studentëve në vende të ndryshme. Mësimi i gjuhëve të huaja është në përputhje me politikën e ndërkombëtarizimit të studimeve. KUB ofron disa programe të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë, mësimdhënia e të cilave zhvillohet në gjuhën angleze. Studentët e programeve të studimeve të ciklit të dytë japin në përfundim edhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtarisht, në përputhje me aktet nënligjore të MAS. Aktualisht, në përputhje me udhëzimin e gjuhës së huaj të nxjerrë nga MAS, studentët e kanë gjuhën e huaj si detyrim hyrës në këtë cikël.

Institucioni favorizon mësimin e gjuhës shqipe nga studentët e huaj. Kreditet e fituara në një institucion të huaj të arsimit të lartë, në kuadër të një marrëveshjeje të përbashkët, transferohen pranë IAL-së.

KUB, përmes një procedure<sup>119</sup> të posaçme, mundëson transferim të krediteve të fituara brenda ose jashtë vendit, nëpërmjet njehsimit të pjesëve ose të programeve të plota të studimeve nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar shkollimin në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm në një institucion homolog.

Ndërkohë, varësisht politikave institucionale dhe vizionit që u jepet studentëve, gjatë këtyre viteve ka pasur lëvizshmëri të tyre dhe të personelit në universitetet jashtë Shqipërisë.<sup>120</sup>

**Programet e studimeve mundësojnë zbatimin në praktikë të njohurive dhe aftësive të fituara nga studentët në kurset teorike.**

Organizimi i programeve akademike u mundëson studentëve edhe praktikimin e aftësive teorike të marra në auditorë. Përveç lëndëve të

<sup>118</sup> Evidenca nr.73

<sup>119</sup> Evidenca nr.15

<sup>120</sup> Evidenca nr.78

praktikave profesionale që janë të detyrueshme brenda kurrikulës së programeve të ndryshme, departamentet, në bashkëpunim me dekanatin e studentëve dhe klubet studentore, si edhe me këshilltarët për planifikimin e karrierës, mundësojnë zhvillimin e praktikave profesionale dhe aktiviteteve të tjera ekstrakurrikulare, si: studenti dhe profesioni, MarCom Seminars, Akademia e Medias dhe Komunikimit, ditët e filmit, debatet e organizuara studentore, Brain Games, kurse me karakter profesional, si arti i komunikimit në publik, montazhi, si dhe vizitat në qendrat për fëmijë me nevoja të veçanta. Aktivitetet e kësaj natyre janë të specifikuara më gjerësisht edhe në “Raportet e aktiviteteve” të KUB-it.<sup>121</sup>

Për të mundësuar te studenti transferimet e mundshme edhe në universitetet jashtë Europës, përbri ECTS-ve, KUB ofron edhe sistemin amerikan të krediteve. Vlerësimet e lartpërmendura janë miratuar nga MAS, në momentin e licencimit të programeve akademike. Në çdo sillabus të lëndës pasqyrohen kreditet në fjalë.

Programet e studimeve përfshijnë përgatitjen e paraqitjen e projekteve kërkimore të studentëve, të specifikuara shprehimisht në rregulloret e studimeve të ciklit të parë dhe të dytë, si edhe në rregulloret specifike të programeve të studimit të ciklit të dytë.

Duke pasur parasysh lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien, në programet e ciklit të dytë, studentët janë nxitur vazhdimisht të ndërmarrin kërkime, të cilat kanë rezultuar në botimin e artikujve dhe në pjesëmarrjen në konferenca të ndryshme.<sup>122</sup>

Në këtë kuadër, është bërë e zakonshme që çdo vit akademik, duke filluar nga viti 2011-2012 e në vazhdim, KUB ka organizuar nga dy konferenca studentore për çdo vit me tematika të ndryshme, të pasqyruara këto në raportet e aktiviteteve. Gjatë këtyre konferencave, studentët e KUB kanë paraqitur kumtesa dhe ajo që përbën risi është që vit pas viti organizimi dhe menaxhimi i këtyre konferencave po u kalon studentëve, por gjithmonë nën kujdesin e KUB. Pjesëmarrja në aktivitetet kulturore, ngritja e qendrës kërkimore të studiuesve të rinj<sup>123</sup> dhe konkurset e vlerësimit të tezave më të mira janë mundësi të arta për zbatimin në praktikë të njohurive dhe aftësive të fituara nga studentët.

### **Programet e studimeve synojnë përgatitjen e studentëve për punësim.**

Nisur edhe nga përcaktimet që parashikon Karta e Bolonjës, praktika profesionale në shumë programe është pjesë e kurrikulës së zbatuar.

Nga ana tjetër, varësisht angazhimit të zyrës së planifikimit të karrierës, gjatë çdo viti akademik, kryesisht gjatë muajve të verës, planifikohen dhe organizohen praktika profesionale në institucione të ndryshme që përshtaten me fushën e studimit. Statistikat për çdo vit akademik mund të

<sup>121</sup> Evidenca nr.58

<sup>122</sup> Evidenca nr.75

<sup>123</sup> Evidenca nr.22

shikohen në shtojcën bashkëngjitur.<sup>124</sup>

### **Përfundimet dhe vlerësimi**

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për fushën e vlerësimit “Kurrikula” konstaton se standardet **janë përmbushur plotësisht.**

Programet e studimit të ofruara janë në përputhje të plotë me misionin e institucionit, duke i qëndruar besnik një fushe konkrete, e cila e ka ndihmuar KUB të krijojë një profil të tijin.

Kolegji Universitar “Bedër” nxit frymën e formimit të vazhdueshëm, duke e bërë atë pjesë integrale të programeve të studimeve.

KUB ofron programe të studimeve, në përputhje të plotë me të gjithë komponentët e strategjisë për zhvillimin e institucionit, përcaktuar në planin strategjik të institucionit, për të cilat ofron informacion të detajuar për të gjithë studentët dhe kandidatët e interesuar. Programet e studimeve janë lehtësisht të kuptueshme me objektiva të përcaktuara qartë dhe lehtësisht të arritshme.

Politikat e KUB janë hartuar në kuadër të politikave kombëtare, të parashikuara në planin strategjik për arsimin e lartë të Ministrisë së Arsimit dhe të Sportit.

Ngarkesa mësimore e pedagogëve caktohet në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi, si edhe në udhëzimet e brendshme të institucionit. Kjo gjë bën të mundur një harmonizim efektiv midis ngarkesës së mësimdhënies dhe angazhimeve të tjera.

Institucioni vlerëson dhe ndjek politika mbështetëse për ecurinë e studentëve, të parashikuara këto në rregulloret përkatëse dhe për këtë qëllim ka ngritur struktura të posaçme.

Organizimi i programeve akademike u mundëson studentëve praktikimin e aftësive teorike dhe përgatitjen e tyre për punësim, prandaj rëndësi të veçantë u kushtohet praktikave profesionale në formë stazhi, që zhvillohen brenda dhe jashtë vendit, në përputhje me marrëveshjet e bashkëpunimit, të nënshkruara nga institucioni.

Varësisht ndryshimeve legislative në fushën e arsimit, KUB po finalizon riorganizimin dhe hapjen e programeve të reja akademike.

<sup>124</sup> Evidenca nr.88

#### 4. Fusha e vlerësimit: Mësimdhënia, mësimnxënia, vlerësimi dhe kërkimi

##### **Organizimi i programeve të studimeve**

##### **Programet e studimeve të shpallura zbatohen në kushte të përshtatshme.**

Institucioni merr masa për sigurimin e mbarëvajtjes së planit mësimor për çdo program. Në çdo fillim semestri miratohen ngarkesat mësimore, shpërndarja e lëndëve, mbledhja e dokumentacionit përkatës për çdo lëndë, plotësimi i programeve mësimore (syllabuseve) etj. Ky proces, në periudha të ndryshme të vitit, auditohet edhe nga një grup pune i emëruar me urdhër nga rektori<sup>125</sup>.

Varësisht nevojave të programeve akademike, KUB ofron mjedise që ndihmojnë studentin për formimin praktik dhe profesional. Të tilla janë qendra e medias dhe komunikimit, laboratorit i gjuhëve të huaja, laboratorit i kompjuterave, salla e gjyqit etj.

Nën kujdesin e dekanit të studentëve, konkretisht zyrës së planifikimit të karrierës, KUB mbikëqyr praktikën dhe stazhet që kryejnë studentët. Për programe të caktuara, si ato në fushën e mësuesisë, ekziston një formular dhe procedurë e caktuar për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e praktikës.<sup>126</sup>

Në lidhje me përgatitjen e temave të diplomës, apo tezave të masterit, çdo student udhëzohet nga një mentor shkencor.

Në mbështetje të mbarëvajtjes së procesit akademik, KUB ka vënë në dispozicion të studentëve dhe personelit bibliotekën e institucionit, e cila ofron një gamë të gjerë titujsh- 36 000, të përzgjedhur sipas programeve të studimit të ofruara, si edhe aksesin në bibliotekën online *EbscoHost*, ku studentët kanë mundësi përdorimi në mbi 45 000 libra dhe mbi 5000 revista shkencore.<sup>127</sup>

##### **Institucionet e arsimit të lartë pajisin studentët që kanë shlyer të gjitha detyrimet e një programi studimi me diplomën përkatëse, e cila është dokument zyrtar.**

Rregullat dhe kërkesat e provimit janë të miratuara nga Senati Akademik nëpërmjet rregulloreve të studimeve dhe provimeve të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë. Kriteret u bëhen studentëve publike përmes rregulloreve përkatëse, të shpallura publikisht, si edhe përmes guidës studentore, e cila u dorëzohet studentëve çdo fillimviti dhe që janë të mundshme në faqen zyrtare *Web* të IAL-së.<sup>128</sup> Fleta e provimit, e hartuar posaçërisht për këtë funksion, përmban elementet e mëposhtme: emërtimin e fakultetit dhe të

<sup>125</sup> Evidenca nr.64

<sup>126</sup> Evidenca nr.67

<sup>127</sup> Evidenca nr.30

<sup>128</sup> Shih: <http://beder.edu.al/sh/fcontent/default/rreguloret-akademike-administrative-19-14/187/204>

departamentit, emërtimin dhe kodin e lëndës, datën, orën, vendin, lektorin, emrin dhe numrin e studentit.<sup>129</sup>

Për organizimin sa më efikas të provimeve, KUB ka miratuar një udhëzim të posaçëm me rregullat e provimeve.<sup>130</sup> Gjithashtu, në lidhje me mbarëvajtjen e provimeve, ekziston rregullorja e disiplinës së studentëve, e cila parashikon masa disiplinore në këtë drejtim.<sup>131</sup>

Ankimimi i rezultateve të provimeve dhe procedura përkatëse është e paraqitur shprehimisht në rregulloret e studimeve dhe provimeve, si edhe në guidën studentore. Në rast se studenti ka ankesa për rezultatin përfundimtar të një provimi semestral, ka të drejtë që, brenda 5 ditëve nga dita e publikimit të rezultateve, të paraqesë një kërkesë pranë sekretarisë mësimore. Ankimimi shqyrtohet paraprakisht nga pedagogu i lëndës, në rast gabimi të mbledhjes së pikëve. Në të kundërt, fleta e provimit rivlerësohet nga një komision i ngritur me vendim të këshillit të departamentit, ku pedagogu i lëndës nuk mund të jetë anëtar.

Studentët kanë mundësi të njihen me rezultatet personale të provimeve. Parimi i konfidencialitetit zbatohet dhe rezultatet e provimeve i bëhen të ditura vetëm studentit në fjalë, nëpërmjet faqes që çdo student ka në sistemin BIS (Bedër information sistem) dhe numrit personal që ka studentit.

### **Programet e studimeve janë objekt i përmirësimit të vazhdueshëm të tyre në funksion të rritjes së cilësisë.**

Me qëllim vlerësimin akademik dhe zhvillimin e cilësisë, pranë KUB është ngritur Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, si dhe një komision i përhershëm të cilët kanë dhe faqen e tyre zyrtare Web.<sup>132</sup> Funksionimi dhe kompetencat e tyre janë të specifikuara në rregulloret përkatëse, si dhe të shprehura në statut.<sup>133</sup> Në këto kompetenca përfshihet zhvillimi dhe monitorimi i anketave që realizohet për personelin akademik nga ana e studentëve, por edhe anketimet e formave të ndryshme, të cilat janë në pesë forma të ndryshme.

Vlerësimi i efektshmërisë së pedagogëve bëhet përmes disa mënyrave, e cila rregullohet sipas rregullores së anketave dhe vlerësimit.

Pedagogët vlerësohen përmes anketimeve të studentëve, vetëvlerësimit të tyre, si edhe vlerësimit të eprorit brenda njësisë.

Në fund të çdo semestri akademik, nëpërmjet anketimeve të përgatitura, studentët japin mendimin e tyre për pedagogun dhe brendinë e lëndës. Kjo anketë realizohet para provimit përfundimtar.<sup>134</sup>

<sup>129</sup> Evidenca nr.69

<sup>130</sup> Evidenca nr.51

<sup>131</sup> Evidenca nr.20: Neni 8,9,10

<sup>132</sup> Shih: <http://qau.beder.edu.al>

<sup>133</sup> Evidenca nr.8; Evidenca nr.9

<sup>134</sup> Evidenca nr.74

Në lidhje me publikimin e rezultateve të provimeve, në respekt të privatësisë së çdo studenti, ato bëhen të njohura nëpërmjet sistemit të automatizimit BIS, ndërsa në lidhje me rezultatet e konkurseve të ndryshme, ato publikohen përmes faqes së internetit të KUB.

Vlerësimi i studentëve për pedagogun dhe brendinë e lëndës është objekt i diskutimit për përmirësimin e lëndës në vitin pasardhës. Zyra e kurrikulave funksionon sipas një rregulloreje dhe procedure të miratuar nga Senati Akademik, tregon rëndësinë që i kushtohet përmirësimit të programeve.<sup>135</sup> Aktualisht në institucion janë bërë disa përmirësime kurrikulare, duke u mbështetur nga të dhënat që merren nga personeli akademik dhe studentët. Pjesë e analizës së programeve ka qenë dhe mbetet niveli i lartë i punësimit të studentëve të diplomuar, përgjegjëse për të cilën është zyra e të diplomuarve.<sup>136</sup>

### **Institucioni ndjek një politikë të qartë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.**

*(Kreu I Standardi II.4)*

Në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të teknikave të mësimdhënies, format e tyre parashikohen në programin mësimor të çdo lënde. Ato mund të jenë në formën e leksioneve, seminareve, projekteve, detyrave të kursit etj.

Vlerësimi i metodave të mësimdhënies është pjesë e rezultateve të mbledhura nga anketat me studentët për çdo lëndë dhe pedagog. Varësisht këtyre rezultateve, departamentet marrin masa për përmirësimin e mëtejshëm të këtyre metodave të mësimdhënies.

Duke synuar garantimin e cilësisë në mësimdhënie, si edhe kualifikimet e personelit në fushën e kërkimit shkencor, KUB gjatë kësaj periudhe ka organizuar disa trajnime, të cilat janë mbështetur nga Këshilli i Sigurimit të Cilësisë dhe zyra e burimeve njerëzore. Një listë e këtyre trajnimeve mund të gjendet në faqen e KSC-së.<sup>137</sup>

Ndërkohë, për zhvillimin e këtyre standardeve, KUB ka ngritur së fundmi Komisionin e Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit.<sup>138</sup>

Për çdo departament, për të minimizuar ngarkesat administrative të ekipit akademik, është caktuar një sekretar i cili ndjek punët administrative të departamentit përkatës. KUB është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies. Ky proces kontrollohet periodikisht nga strukturat e brendshme të institucionit, konkretisht nga NJSBC. KUB vë në dispozicion infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve.

<sup>135</sup> Evidenca nr.24

<sup>136</sup> Evidenca nr.84

<sup>137</sup> Shih: <http://qac.beder.edu.al/pages.php?s=14>

<sup>138</sup> Evidenca nr.2: Neni 8



**Kërkimi: Rezultatet e kërkimit, përhapja, vlerësimi dhe transferimi i tyre**

**Departamenti, si njësi bazë e institucionit, vë në dukje anët e tij të forta dhe dobësitë në fushën e kërkimit shkencor.**

Siç parashikohet edhe në ligjin për arsimin e lartë, por edhe në rregulloret e brendshme institucionale, departamenti është njësi bazë mësimore-kërkimore, që përfshin fusha kërkimi homogjene dhe grupon disiplinat mësimore përkatëse. Objekti i mësimdhënies dhe kërkimit shkencor të departamentit përfshin disa disiplina të një shkence. Hapja, bashkimi ose mbyllja e departamenteve në Kolegjin Universitar “Bedër” bëhet me propozim të këshillit të fakultetit, i cili ia përcjell vendimin Senatit Akademik. Ky i fundit e vlerëson dhe i propozon Këshillit të Lartë miratimin përfundimtar.

Statuti i Kub, në nenet 30 dhe 31 parashikon organizimin e departamentit në grupe mësimore e kërkimore.

Kolegji Universitar “Bedër” merr përsipër krijimin e një mjedisi që favorizon idealin e lirisë akademike dhe autonomisë individuale. Në ushtrimin e lirisë akademike, anëtarët e KUB duhet të mbajnë një qëndrim të ndershëm dhe të përgjegjshëm, për t’i dhënë komunitetit shkencor dhe shoqërisë metodologjinë, rezultatet, për plotësimin dhe ndikimin etik të kërkimeve. Bazuar në misionin e KUB, i cili vlerëson mbështetjen e kërkimit shkencor me qëllim vënien në jetë të ideve dhe projekteve që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe të mbarë shoqërisë, Kolegji Universitar “Bedër”, me anë të udhëzimit mbi nxitjen e publikimeve dhe kërkimit shkencor, mbështet pjesëmarrjen në aktivitete shkencore dhe angazhimin në projekte kërkimore, si edhe shpërblen efektshmërinë akademike vjetore mbi tregues transparentë të parashikuar në rregulloren përkatëse.<sup>139</sup>

Departamenti mbështetet financiarisht në mënyrë transparente dhe të hapur nga institucioni dhe përgjigjet për financimin e grupeve kërkimore. Departamenti, bazuar në rezultatet e punës së grupeve kërkimore, sugjeron vazhdimësinë ose ndërprerjen e bashkëpunimit me to. Në fund të çdo viti akademik bëhet vlerësimi i rendimentit të ekipit akademik, bazuar në reagimin e marrë në vlerësimin e punës shkencore në bazë të treguesve transparentë të botuar në rregulloret përkatëse. Një element tjetër i këtij evidentimi dhe vlerësimi është edhe raporti vjetor që realizon dhe prezanton çdo njësi bazë në rektorat, ku paraqitet analiza SWOT e njësisë përkatëse.<sup>140</sup>

**Institucioni inkurajon zhvillimin, dinamizmin dhe kërkimin shkencor**

Me qëllim mbështetjen e kërkimit shkencor, pranë KUB funksionojnë disa njësi, si: qendrat kërkimore zhvillimore, zyra e kërkimit shkencor, zyra

<sup>139</sup> Evidenca nr.65

<sup>140</sup> Evidenca nr.72

kërkuesve të rinj. Së fundmi është ngritur komisioni i përhershëm për kërkimin shkencor, projektet, aplikimet dhe inovacionin.<sup>141</sup>

Në mbështetje të bashkëpunimit të këtyre njësive me institucione dhe qendra kërkimore të tjera, funksionon zyra e marrëdhënieve ndërkombëtare.

Varësisht këtij ndërveprimi, përveç projekteve të organizuara brenda KUB, ka pasur edhe një sërë projektesh dhe konferencash të përbashkëta me institucione brenda dhe jashtë vendit.<sup>142</sup>

### **Institucioni përqendrohet në ndërkombëtarizimin e kërkimit.**

Duke synuar ndërkombëtarizimin e institucionit, që në fillimet e tij, pranë KUB ka funksionuar zyra për marrëdhëniet ndërkombëtare. Kjo zyrë është ngritur me qëllim që t'u mundësojë studentëve dhe personelit akademik që të fitojnë eksperiencë ndërkombëtare në ushtrimin e veprimtarive kërkimore studimore, të ndihmojë studentët dhe personelin akademik që kanë ardhur nga universitetet jashtë vendit që të integrohen me programet mësimore të institucionit. Duke përfituar maksimalisht nga projektet dhe programet ndërkombëtare në fushën e arsimit, zyra përgjegjëse kontribuon në rritjen e cilësisë arsimore dhe jep kontributin e saj në zhvillimin e shoqërisë.<sup>143</sup>

Përmes kësaj zyre janë nënshkruar një sërë marrëveshjes me universitete dhe qendra kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare, me të cilat në mënyrë të vazhdueshme ka pasur partneritet në organizimin e konferencave, seminareve, projekteve kërkimore, si edhe lëvizshmëri të personelit dhe të studentëve.<sup>144</sup>

Ndër politikat e rëndësishme të KUB është nxitja e personelit akademik të institucionit që të publikojnë punët e tyre kërkimore në revista shkencore ndërkombëtare, në përfundim të të cilave ofrohet dhe një ndihmesë financiare.<sup>145</sup> Duke e mbështetur këtë aktivizim të ekipit akademik, kjo ka sjellë frytet e saj duke bërë që aktualisht personeli të ketë botuar mbi 400 artikuj shkencorë etj.<sup>146</sup>

### **Institucioni përcakton fushat parësore të kërkimit shkencor.**

Udhëzimi i KUB për nxitjen e publikimeve dhe të kërkimit shkencor, në nenin 5 të tij, parashikon kriteret e shpërblimit për kërkimet, inovacionet dhe shpikjet. Liria akademike, të cilën KUB e përkufizon si liri për kryerjen e kërkimit shkencor, të mësimdhënies, të folurit dhe të publikimit, bazuar në standardet e kërkimit shkencor pa ndërhyrje apo ndëshkim dhe pa paragjykuar rezultatet përfundimtare ku studimi mund të çojë, mbetet një

<sup>141</sup> Evidenca nr.47

<sup>142</sup> Evidenca nr.90

<sup>143</sup> Evidenca nr.4: Neni 21

<sup>144</sup> Evidenca nr.91

<sup>145</sup> Evidenca nr.65

<sup>146</sup> Evidenca nr.86



ndër vlerat kryesore të institucionit.<sup>147</sup> Pranë KUB është ngritur komisioni i përhershëm për kërkimin shkencor, projektet, aplikimet dhe inovacionin, i cili ka në përbërje zv.rektorin, që është përgjegjës për kërkimin shkencor, përfaqësues të dy fakulteteve, si edhe koordinatorët e zyrës së kërkimit shkencor dhe qendrës së kërkuesve të rinj.

Gjithashtu, me qëllim mbështetjen e debatit dhe punës kërkimore në fushat parësore të kërkimit shkencor, janë ngritur disa grupe kërkimore, përkatësisht grupi kërkimor për të drejtën ndërkombëtare dhe europiane, grupi kërkimor për të drejtat e njeriut dhe zgjidhjen e konflikteve, grupi kërkimor për studime mediatike, grupi kërkimor i shkencave të edukimit, grupi kërkimor për studime fetare, grupi kërkimor i mësimin të gjuhës angleze si gjuhë e dytë, të cilat bashkëpunojnë me departamentet dhe zyrën e kërkimit shkencor.

Në ushtrimin e lirisë akademike, anëtarëve të stafit akademik të KUB u kërkohet të mbajnë qëndrim të ndershëm dhe të përgjegjshëm, për t'i dhënë komunitetit shkencor dhe shoqërisë metodologjinë, rezultatet, përplotësimin dhe ndikimin etik të kërkimeve.

#### **Institucioni zbaton prioritetet kërkimore-shkencore**

KUB, si institucion i arsimit të lartë me status jofitimprurës, i kushton një rëndësi të veçantë sigurimit të mjeteve dhe infrastruktuës për zbatimin e përparësive të përcaktuara prej tij. Shembull i kësaj është vendimi për krijimin e muzeut të medias, laboratorët e gjuhëve të huaja, pasurimi i bibliotekës në tituj etj. Rregullorja e punësimit, përkrahjes dhe vlerësimit të arritjeve parashikon rekrutimin e personelit akademik të kualifikuar në fushën e kërkimit shkencor, në funksion të strategjisë për zhvillim të institucionit. Bazuar në këtë rregullore, çdo fundviti akademik, njësitë bazë i paraqesin rektoratit kërkesat për ekipin akademik sipas kritereve që ata kërkojnë.

#### **Institucioni siguron vazhdimësi në fushën e kërkimit shkencor.**

Plani strategjik i KUB parashikon tri elemente të rëndësishme për funksionimin e aktivitetit institucional: mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe kontributin në shoqëri. Në këtë këndvështrim, rëndësi e veçantë i kushtohet pranimin të studentëve cilësorë, cilësisë së edukimit, cilësisë së kërkimit shkencor dhe mbështetjes së inovacionit.<sup>148</sup>

Kërkimi shkencor ka qenë në fokus të procesit akademik në KUB, ku gjatë viteve akademike i gjithë personeli ka qenë i angazhuar në punë kërkimore. Publikimet e tij bëhen të ditura në Raportin Vjetor Institucional, i cili dorëzohet në MAS, por edhe në faqen e internetit të institucionit.

KUB ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Në organizimet e konferencave kombëtare dhe

<sup>147</sup> Evidenca nr.3: Neni 23, 24

<sup>148</sup> Evidenca nr.33

ndërkombëtare, KUB ka mbështetur pjesëmarrjen e studiuesve të rinj, veçanërisht të doktorantëve.

Në kuadër të marrëdhënieve që ka ndërtuar me MAS, KUB zbaton politikat shkencore rajonale dhe kombëtare duke i konkretizuar me aktivitete të realizuara dhe të tjera që planifikohen të mbahen në vijim.

KUB ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj dhe për këtë arsye ka punësuar pedagogë të huaj nga disa shtete të ndryshme të botës, si: Turqia, SHBA, Anglia, Gjermania, Spanja, Kosta Rika dhe Kosova. Kolegji Universitar “Bedër” me anë të udhëzimit për nxitjen e publikimeve dhe të kërkimit shkencor, mbështet pjesëmarrjen në aktivitete shkencore dhe angazhimin në projekte kërkimore, si edhe shpërblen arritjet akademike vjetore për indikatorë transparentë të parashikuar në rregulloren përkatëse. Marrëveshjet që ka me universitetet partnere të projektit “Mevlana”, Erasmus+ kanë mbështetur shkëmbimin e personelit akademik dhe të studentëve.

Gjithashtu, institucioni punon ngushtë me agjencitë kombëtare të kërkimit shkencor dhe inovacionit. Në këtë drejtim, KUB ka nënshkruar kartën për studiuesit europianë, në përputhje me orientimin e AKTI. Personeli akademik është trajnuar nga AKTI në drejtim të zbatimit të projekteve dhe të programit Horizont 2020.

KUB aplikon në mënyrë të vazhdueshme me projekte kërkimore në përgjigje të thirrjeve për aplikime në projekte hulumtuese-shkencore në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

Duke parë interesin dhe përfshirjen e vazhdueshme të studentëve në konkurset e tezave të diplomës, projekteve të organizuara si pjesë e programeve mësimore, si dhe pjesëmarrjen aktive në konferenca studentore të organizuara nga KUB por edhe jashtë tij, me vendim të Senatit Akademik ka ngritur "Qendrën për kërkuesit e rinj".<sup>149</sup> Qendra ka për qëllim t'u ofrojë studentëve një mundësi unike për të qenë pjesë e veprimtarisë kërkimore të institucionit, si dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre në fushën e kërkimit shkencor.<sup>150</sup> KUB fton personel akademik të huaj të marrë pjesë në mësimdhënie në formën e leksioneve të hapura, si dhe në angazhime me kohë të pjesshme.<sup>151</sup>

### **Institucioni bën të njohura rezultatet në fushën e kërkimit shkencor.**

Siç vërehet edhe në raportet vjetore të njëpasnjëshme, por edhe në faqen e internetit të institucionit, KUB ka mbështetur dhe ka organizuar në mënyrë periodike konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, seminare etj. Organizime të kësaj natyre janë konferencat ndërkombëtare në shkencat humane, konferencat ndërkombëtare në shkencat e edukimit etj., të cilat në çdo vit kanë ardhur me një tematikë të posaçme. Organizime të ngjashme

<sup>149</sup> Evidenca nr.41

<sup>150</sup> Evidenca nr.105

<sup>151</sup> Evidenca nr.76

janë edhe partneritetet e realizuara në shkallë departamenti me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. Shembuj të këtyre janë konferencat e organizuara për dy vite radhazi mbi studimet e medias dhe komunikimit, ato në fushën e drejtësisë etj.

Në kuadër të bashkëpunimit kombëtar, rajonal dhe më gjerë, janë organizuar edhe disa seminare, me pjesëmarrjen e aktorëve të rëndësishëm të fushave përgjegjëse.

Pas çdo organizimi kërkimor janë përgatitur librat e konferencave, të cilat janë pajisur me ISBN nga Biblioteka Kombëtare, që u janë dërguar pjesëmarrësve të shtypura dhe mund të gjenden në faqen e internetit të KUB.<sup>152</sup>

Gjithashtu, në varësi të dy fakulteteve, publikohen në mënyrë periodike dy revista shkencore, të dyja këto të pajisura me ISSN. Ato janë Beder Journal of Educational Sciences- BJES<sup>153</sup> (ISSN 2306-0557) dhe Beder Journal of Humanities - BJH<sup>154</sup> (ISSN: 2306-6083).

### **Institucioni ndjek një politikë të vlerësimit dhe transferimit të rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.**

Me qëllim ndjekjen dhe vlerësimin e ecurisë së kërkimit shkencor, pranë KUB funksionon zyra e kërkimit shkencor, e cila harton dhe administron politikat që rregullojnë zhvillimin e kërkimeve në KUB dhe mbikëqyr zbatimin e programeve të tij të kërkimit, duke synuar të përmirësojë produktivitetin kërkimor të institucionit dhe të zgjerojë ndikimin e rezultateve akademike të kërkimit në drejtim të rretheve akademike dhe komunitetit.<sup>155</sup>

Në lidhje me mbrojtjen e pronësisë intelektuale, KUB e parashikon atë në marrëveshjen kontraktuale që nënshkruan me anëtarin e ekipit akademik.<sup>156</sup> Në nenin 8 të kësaj kontrate, parashikohet e drejta e autorit dhe e pronësisë industriale.

Së fundmi është ngritur komisioni i përhershëm për kërkimin shkencor, projektet, aplikimet dhe inovacionin, i cili ka për detyrë mbikëqyrjen e progresit dhe raporteve përfundimtare të të gjitha granteve dhe projekteve të kërkimit.

Udhëzimi mbi nxitjen e publikimeve dhe kërkimit shkencor, në nenin 5 të tij, parashikon kriteret e shpërblimit për kërkimet dhe rezultatet në fushën e kërkimit shkencor. Me qëllim që personeli akademik të marrë pjesë në veprimtari shkencore brenda dhe jashtë vendit, ky i fundit përcakton edhe buxhetin.

<sup>152</sup> Shih: <http://beder.edu.al/en/content/default/publications-12-2/8/165>

<sup>153</sup> Shih: <http://bjes.beder.edu.al/>

<sup>154</sup> Shih: <http://bjh.beder.edu.al/>

<sup>155</sup> Evidenca nr.11

<sup>156</sup> Evidenca nr.53

KUB bashkëpunon me biznesin vendas dhe të huaj, si dhe merr në konsideratë faktorët ekonomikë dhe socialë. Institucioni gjatë aktivitetit akademik ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me kompani të sektorit privat si brenda, ashtu edhe jashtë vendit. Një rëndësi e veçantë i është kushtuar biznesit vendas, me të cilin janë vendosur urat e bashkëpunimit. Kërkimet shkencore, siç janë konferenca shkencore ndërkombëtare të organizuara nga KUB, janë botuar në librat përkatës të konferencave, të pajisur me ISBN nga Biblioteka Kombëtare. Në këtë kuadër, KUB gjatë viteve akademike 2015-2016 dhe 2016-2017, organizoi një projekt të përbashkët kërkimor me Autoritetin e Mediave Audiovizuale<sup>157</sup>, siç ka pasur edhe raste të tjera në fusha të ndryshme.

KUB mbështet iniciativat kërkimore të studentëve nëpërmjet organizimit të konferencave studentore dhe konkurseve të tezave. Në këtë kuadër janë organizuar disa konkurse, fituesit e të cilëve janë shpërblyer financiarisht.<sup>158</sup>

E themeluar rishtazi, Qendra e Kërkuesve të Rinj shërben si një mundësi për të gjithë pjesëmarrësit për propozimin e iniciativave kërkimore-shkencore. Në këtë kuadër, pas trajnimit të studentëve lidhur me metodat kërkimore dhe hartimin e projekteve, qendra ka organizuar konkursin e parë për propozimet e projekteve kërkimore, kurse projektet fituese do të financohen nga KUB ose do të paraqiten pranë institucioneve donatore.<sup>159</sup>

### **Përfundimet dhe vlerësimi**

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për fushën e vlerësimit “Mësimdhënia, mësimnxënia, vlerësimi dhe kërkimi” konstaton se standardet **janë përmbushur plotësisht.**

Institucioni dëshmon se programet e studimeve zbatohen në kushte të përshtatshme dhe në mjedise të ofruara në përputhje me nevojat e programeve akademike.

Institucioni ka të përcaktuara qartë rregullat dhe kërkesat e provimit, si dhe ankimin e rezultateve, të cilat u bëhen publike studentëve përmes rregulloreve përkatëse të botuara në faqen zyrtare Web të IAL-së.

Sistemi BIS (Bedër Information Sistem)<sup>160</sup> u siguron studentëve garantimin e rezultateve personale të provimeve, në respekt të plotë të parimit të konfidencialitetit.

Institucioni ka politika të qarta dhe siguron vlerësimin akademik, zhvillimin dhe përmirësimin e cilësisë. Kjo bëhet përmes njësive përkatëse për sigurimin e cilësisë, si dhe duke u bazuar te Manuali i Sigurimit të Cilësisë.<sup>161</sup> Vlerësimi i mësimdhënies realizohet nëpërmjet rezultateve të

<sup>157</sup> Shih: iccms.beder.edu.al

<sup>158</sup> Evidenca nr.105

<sup>159</sup> Evidenca nr.70

<sup>160</sup> Evidenca nr.108

<sup>161</sup> Evidenca nr.68

mbledhura nga anketat me studentë për çdo lëndë dhe pedagog, varësisht të cilave, departamentet marrin masat për përmirësimin e mëtejshëm të tyre.

Zyra e kurrikulave është një tjetër tregues për rëndësinë që i kushtohet përmirësimit të programeve.<sup>162</sup>

Institucioni ka në fokus të procesit akademik kërkimin shkencor, në të cilin gjatë viteve akademike i gjithë ekipi është angazhuar në punë kërkimore.

KUB mbështet kërkimin shkencor nëpërmjet krijimit të një mjedisi që favorizon idealin e lirisë dhe autonomisë individuale, si dhe shpërblimit të arritjeve akademike vjetore mbi të dhëna transparente të parashikuara në rregulloren përkatëse.

Departamenti mbështetet financiarisht nga institucioni dhe përgjigjet për financimin e grupeve kërkimore.

Pranë KUB funksionojnë disa njësi, si: qendrat kërkimore zhvillimore, zyra e kërkimit shkencor, zyra e kërkuesve të rinj, si dhe komisioni i përhershëm për kërkimin shkencor, projektet, aplikimet dhe inovacionin, të cilat mbështetin debatin dhe punën kërkimore në fushat parësore të kërkimit shkencor.

KUB organizon në mënyrë periodike konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, seminare etj., në kuadër të bashkëpunimit kombëtar, rajonal dhe më gjerë, pas të cilave përgatiten librat e konferencave, të pajisur me ISBN nga Biblioteka Kombëtare, që u dërgohen pjesëmarrësve si dhe publikohen në faqen e internetit të KUB.

Gjithashtu publikohen në mënyrë periodike edhe dy revista shkencore, të dyja këto të pajisura me ISSN.

Në mbështetje të studentëve që janë angazhuar në kërkimin shkencor institucioni ofron konkurse, projekte të organizuara si pjesë e programeve mësimore, nxit pjesëmarrjen aktive në konferenca studentore, si dhe ka hapur qendrën për kërkuesit e rinj.

Pas një eksperience disavjeçare në fushën e arsimit të lartë, sugjerohet angazhimi më i madh i institucionit në projekte kërkimore të mbështetura nga organizma kombëtare dhe ndërkombëtare, si: AKTI, BE, KE.

---

<sup>162</sup> Evidenca nr.31

## 5. Fushat e vlerësimit: studentët dhe mbështetja e tyre

Studentët: Nga regjistrimi deri te punësimi

### **Institucioni ndjek një politikë korrekte për pranimin e studentëve të rinj.**

Që në fillim duhet theksuar se KUB është një institucion që ka kritere në pranimin e studentëve. Varësisht politikave institucionale si një institucion jofitimprurës, KUB ka pranuar një numër të kufizuar studentësh, në përputhje me infrastrukturën fizike dhe të burimeve njerëzore që zotëron. Përmes kësaj politike, KUB ka synuar angazhimin maksimal të ekipit ndaj studentit, duke respektuar të gjitha kriteret e kërkuara në këtë drejtim.

Përmes faqes së internetit, broshurave, takimeve të drejtpërdrejta, panairove etj., KUB bën publike ofertën vjetore të programeve që ofron.

Në kuadër të këshillimit të karrierës, përkrah aktiviteteve të mësipërme, KUB organizon edhe ditët e hapura, apo edhe ditët e orientimit për studentët e rinj.

Procedurat e pranimit të studentëve për çdo vit akademik, si edhe kuotat për çdo program studimi, së bashku me kriteret e pranimit, i dërgohen ministrisë përkatëse, si edhe i bën publike përmes faqes së internetit.

Varësisht afateve të përcaktuara nga agjencitë shtetërore, KUB mban lidhje të ngushta me drejtoritë arsimore rajonale dhe, përmes lejeve të siguruara prej tyre, viziton shkollat e mesme në qytete dhe qendra të ndryshme të vendit. Përmes kësaj praktike, maturanët e këtyre shkollave njihen me ofertën akademike të KUB.

Për pritjen dhe shpjegimin e ofertës akademike, KUB ka ngritur zyrën e përzgjedhjes dhe pranimit të studentëve.

Me qëllim realizimin e një procesi mësimor sa më rezultativ, KUB i kushton një rëndësi të veçantë raportit numerik personel akademik/student, i cili siguron edukimin cilësor dhe objektivat e institucionit. Raporti në fjalë është 1 (një) personel akademik për 10.03 studentë në shkallë institucionale.

### **Institucioni ndjek një politikë të informimit të studentëve dhe siguron komunikimin ndërmjet tyre dhe personelit akademik.**

Me qëllim për të garantuar një komunikim sa më të shpejtë midis institucionit dhe studentit, KUB ndjek politikë mbështetëse për studentët, nëpërmjet veprimtarive të orientimit dhe të kujdestarisë. Çdo grup i caktuar studentësh është nën përkujdesjen e një këshilltari akademik, i cili ndihmon në mbarëvajtjen e çështjeve mësimore.<sup>163</sup>

Përveç kësaj, sekretaria mësimore, në çdo kat bën afishimet e njoftimeve të ndryshme në tabelat e vendosura, bën njoftime edhe me anë të postës

<sup>163</sup> Evidenca nr.6: Neni 6



elektronike në adresat personale që kanë studentët të ofruara nga zyra e IT në KUB.

Në momentin e nënshkrimit të kontratës, zyra e IT-së pajis me një adresë institucionale të gjithë studentët e regjistruar.

Në lidhje me njoftimet për studentët e regjistruar, apo edhe për ata të rinj që shprehin interes, KUB përdor faqen zyrtare të internetit, si edhe profilet në rrjetet sociale, si mjete të rëndësishme të komunikimit të jashtëm. Në këtë funksion, pranë KUB shërben edhe zyra e protokollit dhe korrespondencës.

Studentët e regjistruar në KUB informohen në kohë reale përmes sistemit BIS, ku në ekranin e gjithsecilit shfaqet njoftimi përkatës.

Komunikimi i brendshëm në KUB kryhet nëpërmjet sekretarive të ngritura pranë njësive bazë dhe njësive kryesore. Personeli i institucionit ka një adresë elektronike të brendshme. Departamenti i IT-së pajis çdo anëtar të personelit me adresë poste elektronike të formës: Shkronja e parë e emrit, mbiemrit@beder.edu.al.

Në përmbushje të kërkesave të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit, që në momentin e regjistrimit, KUB plotëson dosjen personale të çdo studenti konform rregullave ligjore. Dosjet në fjalë mbahen në zyrën e sekretarisë mësimore. Një hap pozitiv është bërë përsa i përket pjesëmarrjes së studentëve si të ftuar në mbledhjet e njësive bazë dhe kryesore.<sup>164</sup>

Po ashtu në Senatin Akademik, në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm Cilësisë, si dhe në komisionet e përhershme ata janë anëtarë me të drejta të plota.<sup>165</sup>

### **Institucioni ndjek një politikë të orientimit dhe këshillimit të studentëve.**

Për të ndihmuar studentët në orientimin dhe këshillimin e karrierës, KUB ka ngritur zyrën e planifikimit të karrierës, e cila funksionon pranë dekanatit të studentëve. Në këtë zyrë, çdo departament emëron një këshilltar për planifikimin e karrierës, i cili ofron konsulencë për studentët e regjistruar.

Këshilltari i karrierës informon studentët mbi organizimin e seminareve, rreth teknikave të kërkimit të punës, të shkrimit të CV-së dhe kalimit me sukses të intervistës paraprake; kërkon mundësitë e punësimit për të gjithë studentët e diplomuar në programet “Bachelor” dhe “Master”, organizon aktivitete të cilat synojnë ruajtjen e marrëdhënieve mes studentëve edhe pas diplomimit të tyre etj.<sup>166</sup>

Programet e studimeve në KUB janë hartuar duke u bazuar në kriteret e përcaktuara në Deklaratën e Bolonjës, në mënyrë që të mundësojnë përshtatjen progresive të studentit me programin e studimit. Raporti i

<sup>164</sup> Evidenca nr.39

<sup>165</sup> Evidenca nr.1; Evidenca nr.2

<sup>166</sup> Evidenca nr.5: Neni 42

lëndëve në formimin e përgjithshëm profesional, teknik etj. janë të përcaktuara sipas këtyre standardeve dhe kritereve ligjore të përcaktuara nga MAS.

Në mënyrë periodike, KUB informon studentët në lidhje me çdo zhvillim të rëndësishëm institucional. Metodatat e informimit janë të ndryshme, si me anë të faqes së internetit, ashtu edhe me vënien në dispozicion të studentëve të materialeve ose broshurave informuese. Këto të fundit mund t'u jepen në dorë ose mund të lihen në ambientet e përbashkëta, ku studentët kanë mundësi t'i përdorin.

Në KUB, nëpërmjet strukturave të këshilltarëve akademikë dhe këshilltarëve të karrierës, studentët mbështeten për zgjidhjen e nevojave të tyre në të gjitha ciklet e studimeve.

Organizimi dhe mbështetja që u bëhet klubeve studentore në çdo aspekt, si dhe në atë akademik dhe financiar, është një tregues i rëndësishëm i politikës mbështetëse për studentët.

### **Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për kategori sociale të veçanta**

KUB, edhe pse aktualisht vazhdon aktivitetin në ambiente të marra me qira, që në fillim ka kërkuar përgatitjen e terrenit dhe mjeteve të nevojshme, pjesë këto të një politike mbështetëse për studentët me aftësi të kufizuara. Rëndësia që i është dhënë kësaj kategorie shprehet në aktet më të rëndësishme të institucionit, si p.sh. neni 57, 58 i rregullores themelore.

Në ambientet e hyrjes së godinës kryesore të institucionit është bërë e mundur që në vend të shkallëve të ketë sipërfaqe të rrëshqitshme për përdorimin e mjeteve ndihmëse për këtë kategori sociale të veçantë, ndërsa në godinë lëvizjen e brendshme e siguron instalimi i ashensorit. Janë marrë masat që të krijohen kushte në nyjat hidro-sanitare posaçërisht për këta persona.

KUB ndjek politikë mbështetëse për të gjithë studentët pa dallim race, ngjyre, kombësie, besimi fetar etj. Për studentët romë dhe ballkano-egjiptianë ofrohen mundësi të barabarta me të tjerët, si edhe në raste të ndryshme, strukturat e ngritura për mundësimin e bursave të studimit, të akordojnë të tilla bursa për këto grupe.

KUB mbështet të gjithë ata studentë që në fusha të ndryshme kanë treguar aftësi të veçanta dhe kanë fituar çmime. Angazhimi në aktivitete sportive të niveleve të larta mbështetet dhe nxitet institucionalisht. Gjithashtu, KUB ofron bursa për grupe të caktuara, për persona me aftësi të kufizuara<sup>167</sup>, për persona me fatkeqësi familjare, për fëmijët e dëshmorëve të policisë, si dhe për disa kategori të tjera, si punonjësit e Ministrisë së Brendshme etj.<sup>168</sup>

<sup>167</sup> Evidenca nr.101

<sup>168</sup> Evidenca nr.102

**Institucioni ofron literaturë bazë dhe ndihmëse për studentët.**

Zyra e menaxhimit të bibliotekës është përgjegjëse për menaxhimin e procesit të regjistrimit të titujve të ardhur në bibliotekë. Kjo zyrë është përgjegjëse për rregullimin, monitorimin dhe arkivimin e çdo regjistrimi, informacioni, dokumenti ose shënimi, lidhur me fondin e përgjithshëm të bibliotekës. Zyra funksionon në bazë të udhëzimit mbi funksionimin e bibliotekës.<sup>169</sup>

Biblioteka e KUB, e cila është në dispozicion të studentëve çdo ditë të javës nga e hëna në të shtunë, ofron një gamë të gjerë titujsh, në total 36 000. Këta tituj janë të përzgjedhur dhe klasifikuar në përputhshmëri me programet e studimit të ofruara nga KUB.

KUB parashikon fonde për blerjen e literaturës së specializuar në fushën e kërkimit shkencor, duke i akorduar çdo departamenti një fond të caktuar për pasurimin e bibliotekës me botimet dhe publikimet më të fundit të fushës.

Pasurimi i bibliotekës është bërë edhe përmes një projekti studentor “Unë dhuroj, dhuro edhe ti!”<sup>170</sup> i organizuar përmes një fushate sensibilizuese për mbledhjen e librave, nga studentët e departamentit të shkencave të komunikimit, në kuadër të së cilës u mbledhën rreth 10 000 libra. Një pjesë e tyre u përdor për pasurimin e bibliotekës së institucionit, ndërsa pjesa tjetër u dhurua për shkolla dhe institucione të tjera.

KUB ofron nëpërmjet bibliotekës literaturë shumëdisiplinare. Oraret e punës të bibliotekës shpallen në mjediset e institucionit. Ato janë të bëra publike në hyrje të bibliotekës, mjediset e së cilës janë të disponueshme deri në orën 19:00 të mbrëmjes. Në periudhë provimesh, biblioteka qëndron e hapur edhe gjatë fundjavës.

Në funksion të bibliotekës, KUB ka vënë në dispozicion edhe sistemin e automatizimit.<sup>171</sup> Sipas këtij sistemi, kërkesa për sigurimin e literaturës dhe regjistrimet e studentëve bëhen në formë elektronike.

Biblioteka ofron sigurimin e materialeve në rrugë elektronike. Kjo mundësohet nga abonimi që është bërë në bibliotekën online *Ebsco Host* ku studentët kanë akses në 45 000 libra dhe 5000 revista. Gjithashtu biblioteka e KUB mundëson komunikimin dhe në *Book Academic Collection*.<sup>172</sup>

**Institucioni u ofron studentëve të ciklit të parë mbështetje nëpërmjet shërbimeve universitare për të lehtësuar ecurinë e tyre.**

Institucioni nëpërmjet veprimtarive të orientimit dhe të kujdestarisë ndjek politika mbështetëse për studentët. Çdo grup i caktuar studentësh është nën përkujdesjen e një këshilltari akademik, i cili ndihmon në mbarëvajtjen

<sup>169</sup> Evidenca nr.26

<sup>170</sup> Evidenca nr.58

<sup>171</sup> Shih: <http://library.beder.edu.al/>

<sup>172</sup> Evidenca nr.30

e çështjeve mësimore. Kjo parashikohet në nenin 6 të rregullores për studimet e ciklit të parë dhe provimeve.

Literatura e nevojshme për lëndët e ofruara, bëhet e ditur me anë të programit të lëndës që në fillim të semestrit. Pedagogët e lëndëve kërkojnë nga departamenti që të sigurohen në bibliotekë të paktën disa kopje nga literatura e nevojshme. Biblioteka zotëron titujt kryesorë të përfshirë në literaturën e domosdoshme të çdo programi.

KUB në ndihmë të studentëve ngarkon personelin akademik me orë shtesë, të emërtuara si orë zyre në funksion vetëm të studentëve; kjo për t'i ndihmuar ata që hasin vështirësi.

Rishtazi, për studentët që kanë vështirësi, janë organizuar edhe kurse intensive të gjuhës angleze.

### **Institucioni inkurajon pjesëmarrjen e studentëve në jetën institucionale.**

Studentët në KUB, me anë të kryetarit të këshillit studentor përfaqësohen në organet drejtuese të institucionit, në strukturat mësimore-kërkimore dhe ato të shërbimeve. Kjo parashikohet si në Statutin e KUB dhe në rregulloren e organizimit akademik.

Këshillat e studentëve shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm, për planet mësimore dhe programet e studimeve, rregulloret e studimeve etj. Studentët janë të përfshirë me përfaqësuesit e tyre si në Senatin Akademik, ashtu dhe në NJSBC.

Nëpërmjet buxhetit të dekanatit të studentëve, KUB mbështet këshillat dhe klubet e studentëve dhe financon veprimtarinë e tyre. Klubet e studentëve synojnë që, në përputhje me rregullat, mjedisin dhe disiplinën në KUB, të zhvillojnë studentët në aspektin social, kulturor, intelektual dhe sportiv.<sup>173</sup> Klubet studentore funksionojnë në bazë të udhëzimit mbi klubet studentore.<sup>174</sup>

### **Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për të siguruar cilësinë e jetës studentore.**

Për të siguruar cilësinë e jetës studentore, një rol të rëndësishëm luan dekanati i studentëve. Njësitë në varësi të dekanatit të studentëve angazhohen në organizimin e aktiviteteve të ndryshme sociale dhe kulturore. Këto aktivitete shpesh organizohen në kuadër të klubeve studentore.

Për garantimin e sigurisë së studentit, institucioni ka kontraktuar kompani të sigurimit fizik, përfaqësuesit e të cilave ndodhen 24 orë në mjediset e KUB.<sup>175</sup>

<sup>173</sup> Evidenca nr.82

<sup>174</sup> Evidenca nr.27

<sup>175</sup> Evidenca nr.97

Garantimi higjieno-sanitar brenda mjediseve të KUB, është siguruar përmes një marrëveshjeje të nënshkruar me një shoqëri të fushës.<sup>176</sup> Nga ana tjetër, për përkujdesjen shëndetësore, përveç pranisë së mjekut pranë institucionit, KUB ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Spitalin Amerikan, i cili ofron zbritje të tarifave për shërbimet mjekësore të studentëve dhe të personelit.<sup>177</sup>

#### **Institucioni favorizon punësimin e studentëve.**

Në kuadër të zyrës së dekanit të studentëve është hapur zyra e të diplomuarve, si dhe zyra e planifikimit të karrierës, përgjegjësitë e së cilës parashikohen në rregulloren e organizimit administrativ, pjesa që përshkruan funksionet e dekanit të studentëve.

KUB, nëpërmjet praktikave profesionale gjatë të gjithë vitit dhe marrëveshjeve të nënshkruara me kompani të ndryshme, mundëson një tranzicion të lehtë në punësim. Nëpërmjet zyrës së planifikimit të karrierës, personeli akademik, ai ndihmës mësimor-shkencor dhe personeli administrativ angazhohen për zbatimin e politikës së punësimit të studentëve.

Në politikat e KUB parashikohen politika favorizuese për punësimin e të diplomuarve të vet. Aktualisht janë punësuar 15 të diplomuar pranë institucionit, si dhe 87% e të diplomuarve janë punësuar dhe/ose ndjekin një cikël tjetër studimesh.

Institucioni nëpërmjet këtyre zyrave ka statistika të sakta në lidhje me të diplomuarit e saj.<sup>178</sup>

#### **Përfundimet dhe vlerësimi**

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për fushën e vlerësimit “Studentët dhe mbështetja e tyre” konstaton se standardet **janë përmbushur plotësisht**.

Institucioni dëshmon se ndjek politika ndihmëse në pranimin e studentëve që plotësohen me angazhimin maksimal të personelit ndaj studentit. Për këtë arsye, KUB pranon një numër të kufizuar studentësh, në përputhje me infrastrukturën fizike dhe të burimeve njerëzore.

Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për studentët dhe siguron një komunikim të shpejtë dhe efektiv ndërmjet institucionit dhe studentit, përmes veprimtarive të orientimit dhe të kujdestarisë, si dhe sekretarisë mësimore, përfaqësimit të tyre në organet vendimmarrëse të IAL-së etj.

Institucioni siguron informacion në kohë reale përmes sistemit BIS, si dhe nëpërmjet sekretarive të ngritura pranë njësive bazë dhe njësive kryesore.

KUB ndjek politikë mbështetëse për të gjithë studentët dhe siguron ambiente dhe mjete të nevojshme për studentët me aftësi të kufizuara. KUB ndjek politika mbështetëse për studentët me aftësi të veçanta dhe që kanë fituar çmime, duke ofruar zbritje nga tarifa e studimit deri në 100% të saj.

<sup>176</sup> Evidenca nr.98

<sup>177</sup> Evidenca nr.99

<sup>178</sup> Evidenca nr.84

Institucioni ofron literaturë bazë dhe ndihmëse për studentët nëpërmjet bibliotekës, që ofron një gamë të gjerë titujsh të përzgjedhur, në përputhshmëri me programet e studimit të ofruara nga KUB.

Institucioni siguron nivelin e arsimimit nëpërmjet sigurimit të sigurisë në ambientet e institucionit, garantimit higjieno-sanitar dhe përkujdesjes shëndetësore, si dhe angazhimit në organizimin e aktiviteteve të ndryshme sociale dhe kulturore.

Institucioni nëpërmjet praktikave profesionale dhe marrëveshjeve të nënshkruara me kompani të ndryshme mundëson një tranzicion të lehtë në punësim.



## Përfundimet dhe vlerësimi përgjithshëm

***Nisur nga analiza e çdo fushe të trajtuar më sipër, rezulton se Kolegji Universitar “Bedër” i ka përmbushur plotësisht standardet e cilësisë për arsyet si më poshtë vijon:***

1. *KUB është institucion arsimor jofitimprurës.* Kolegji Universitar “Bedër” gëzon statusin e një institucioni jofitimprurës, gjë kjo që mundëson vendosjen e studentit në qendër dhe ku çdo e ardhur kthehet në investim për studentin.
2. *Plani Strategjik 2017-2022.* Institucioni është në proces të hartimit të planit të ri strategjik 5-vjeçar, i cili përdoret si manual për realizimin e objektivave. Përgatitja e këtij plani ka nisur pas përfundimit dhe analizës që i është bërë planit strategjik pararendës për vitet 2012-2017.
3. *Ndërtimi i institucionit dhe i programeve mbi bazën e një vizioni, misioni dhe plani të zhvillimit strategjik të qartë, të plotë, dhe modern.* Dokumenti i planit strategjik të zhvillimit të institucionit orienton drejt dhe në mënyrë objektive zhvillimin në kontekstin e një institucioni me profil kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.
4. *Personeli akademik i kualifikuar dhe ndërkombëtar.* Personeli akademik i ardhur nga tetë shtete të ndryshme të botës përbën një tjetër pikë të fortë të KUB. Përveç ekipit vendas, personeli akademik i punësuar ndër vite në KUB, nga Anglia, Egjipti, Gjermania Kosova, Spanja, SHBA dhe Turqia ka qenë dhe mbetet një përparësi për institucionin tonë.
5. *Përparësia dhe rëndësia kushtuar kërkimit shkencor.* KUB i ka kushtuar një rëndësi të veçantë kërkimit shkencor. Gjatë kësaj periudhe ka organizuar 22 konferenca ndërkombëtare, 4 kombëtare dhe disa seminare. Konferencat dhe seminarat kanë qenë me një pjesëmarrje të gjerë referuesish nga bota që shkon deri në 19 vende dhe ka ngritur struktura përkatëse të cilat mbështesin kërkimin shkencor për personelin akademik dhe studentët.
6. *Programe bashkëkohore studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit, si dhe planin strategjik.* Të gjitha programet e KUB garantojnë përgatitjen e studentëve në përputhje me objektivat, profilin e përcaktuar dhe planin strategjik. Në hartimin e programeve është marrë si pikë referimi eksperiencia dhe prirja e universiteteve më të njohura në nivel global dhe në përputhje të plotë me kriteret e Kartës së Bolonjës.
7. *KUB është një institucion i arsimit të lartë i profilizuar.* KUB është institucion i fokusuar në fushën e shkencave sociale dhe humane. Në këtë mënyrë, KUB synon të kthehet në një pikë referimi për studime në këtë fushë.

8. *KUB ofron programe unike.* Në përbërje të Fakultetit të Shkencave Humane, operon i vetmi departament ku mund të studiohen shkencat islame në Shqipëri. Departamenti ofron programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë.
9. *Bashkëpunimi me institucione arsimore dhe biznese brenda dhe jashtë vendit.* Bashkëpunimet me universitete të ndryshme në botë dhe institucione që ofrojnë asistencë profesionale praktike për studentët, janë një tjetër anë e fortë që KUB ofron.
10. *Mësimdhënie në gjuhën shqipe, angleze dhe atë turke.* Mësimdhënia në KUB zhvillohet e koordinuar: në gjuhën angleze, turke dhe atë shqipe. Kjo u jep mundësi studentëve që deri në momentin e diplomimit të mund të flasin rrjedhshëm të paktën një gjuhë të huaj, kurse një gjuhë tjetër u ofrohet në mënyrë ekstrakurrikulare.
11. *Infrastrukturë logjistike, IT dhe sistemi i automatizimit (BIS).* Administrimi online i të dhënave nga njësitë kryesore rrisin cilësinë e shërbimeve ndaj studentëve dhe transparencën ndaj tyre, duke i ardhur në ndihmë personelit. Ndërkohë, KUB është i pajisur me të gjitha kushtet e nevojshme për të zhvilluar një proces mësimor sa më bashkëkohor. Pajisja e ambienteve mësimore me kushte kondicionimi, tabela interaktive (Smart Borde), projektorë, kompjutera, karrige ortopedike etj., mundësojnë një proces mësimor cilësor.
12. *Bursat dhe tarifat e aplikuara.* Bursat dhe tarifat e studimeve të aplikuara në KUB për të dyja ciklet e studimeve, janë konkurruese dhe motivuese për studentët, gjë kjo e reflektuar në cilësinë e studentëve të pranuar.
13. *Ndërkombëtarizimi i institucionit.* Përveç ekipit akademik nga 8 vende të ndryshme, në KUB ka edhe studentë të ardhur nga 16 shtete të ndryshme të botës. KUB është kthyer në një qendër studimi për të rinj të ardhur nga 16 shtete të ndryshme të botës. Diversiteti kulturor i personelit shton një tjetër mënyrë komunikimi dhe eksperience.
14. *Prania e dekanit të studentëve (zyrës së marrëdhënieve me studentët).* Një rol të rëndësishëm në jetën studentore në KUB, luan dekanati i studentëve. Kjo njësi ndihmon në sigurimin e aktiviteteve të organizuara nga klubet studentore: praktika profesionale brenda dhe jashtë vendit, planifikimin e karrierës etj.
15. *Pranim të studentëve bazuar në kriteret e cilësisë.* KUB zbaton kriteret të caktuara për pranimin e studentëve.
16. *Reputacion i lartë i imazhit institucional.* Kjo pasqyrohet në katër komponentë kryesorë. I pari, numri i lartë i aplikimeve për punësim; i dyti, punësimi i lartë që kanë siguruar studentët e diplomuar, i treti, ndjenja e lartë e përkatësisë institucionale të personelit; i katërti, vlerësimi tejet pozitiv i studentëve, të dhëna këto të bazuara në statistikat e anketave të zhvilluara brenda institucionit.

17. *Baza e të dhënave për studentët dhe personelin akademik.* Zotërimi i të dhënave të regjistruara dhe përdorimi elektronik i tyre ka krijuar përparësi në mbajtjen e më shumë të dhënave, për t'i organizuar ato në mënyra të ndryshme, për t'i përdorur më lehtësisht nga të interesuarit, gjithmonë duke u bazuar në parimet e konfidencialitetit.
18. *Punësimi i të diplomuarve:* Aktualisht nga 497 të diplomuar janë punësuar 430 ose janë në proces të ndjekjes së një cikli studimi më të lartë.
19. *Akreditimi institucional dhe i çdo programi studimi:* Pasja e vendimeve të akreditimit institucional dhe të çdo programi studimi ka treguar për një qëndrueshmëri dhe besnikëri të institucionit ndaj standardeve të cilësisë.
20. *Vëmendja e kushtuar ndaj çështjeve me karakter social.* KUB u ka kushtuar një rëndësi të veçantë studentëve me aftësi të kufizuara. KUB ka ndjekur një politikë gjithëpërfshirëse të studentëve në aktivitete të ndryshme me karakter social dhe sensibilizues.
21. *Përfshirja e studentëve në vendimmarrje.* Përmes përfshirjes së studentëve në organe të ndryshme kolegjiale vendimmarrëse, KUB u ka mundësuar atyre që jo vetëm të informohen rreth zhvillimeve të institucionit, por të kenë mundësinë për të qenë pjesë e vendimmarrjes.
22. *Angazhimi i studentëve në kërkimin shkencor.* Me ngritjen e qendrës së kërkuesve të rinj, KUB u ka ofruar studentëve mundësi për të qenë të përfshirë në projekte kërkimore individuale apo në grup.

***Ndërkaq, për të përmirësuar këto standarde, Grupi i Vlerësimit të Brendshëm gjykon dhe rekomandon:***

1. Institucion relativisht i ri. Duke qenë një institucion ende i ri me një përvojë akademike 6-vjeçare, edhe pse ka qenë pjesë në disa projekte përfshirja në projekte më të mëdha mbetet një pikë për t'u zhvilluar më tej .
2. Nevoja për personel akademik sipas fushave të veçanta të specializimit. Edhe pse në të gjitha programet dhe njësitë bazë numri i personelit akademik është konform standardeve të kërkuara, del e këshillueshme që personeli akademik të pasurohet me anëtarë që mbulojnë fusha specifike, sidomos në fushën e studimit të shkencave islame, e rëndësishme kjo për cilësinë në mësimdhënie.
3. Rritja e sipërfaqes së ambienteve për aktivitete të ndryshme sociale për studentët. Pavarësisht kushteve të kënaqshme që ofron godina institucionale, bie në sy mungesa e hapësirës së gjelbër dhe sportive të ofruara në funksion të studentëve. Nxitja e përfundimit të ndërtimit të kampusit të ri do të ishte dhe zgjidhja më efikase për këtë.

4. Personeli dhe studentët e huaj. Duke pasur prurje nga vende të ndryshme të personelit dhe të studentëve, institucioni është përballur me disa vështirësi burokratike në plotësimin e dokumentacionit të tyre.
5. Përmirësim i aktivitetit të qendrave kërkimore-shkencore. Edhe pse në institucion operojnë dy qendra kërkimore-shkencore, aktiviteti i tyre duhet përmirësuar dhe rritur cilësisht. Ato mund të iniciojnë projekte dhe kërkime të ndryshme shkencore, por edhe mund të bëhen pjesë e projekteve me institucione të tjera partnere, vendase dhe të huaja.

***Nga ana tjetër, duhen vlerësuar edhe disa mundësi që KUB duhet t'i trajtojë më me kujdes dhe t'i ketë pjesë të planifikimit strategjik 2017-2022***

1. KUB dëshmon perspektivën për t'u bërë një aktor dhe faktor i rëndësishëm në disiplinat e ofruara, jo vetëm në Shqipëri dhe rajon, por edhe më gjerë.
2. Pozicioni gjeografik dhe strategjik i Shqipërisë në rajon, i ofron KUB perspektivën për t'u kthyer në një qendër ndërkombëtare studimesh.
3. Zbatimi i lëvizjes së lirë të personelit dhe të studentëve përmes marrëveshjeve të arritura me institucione të arsimit të lartë brenda dhe jashtë Shqipërisë.
4. Procesi i integritimit të Shqipërisë do të mundësojë përfitimet e fondeve nga Bashkimi Europian, si dhe pjesëmarrje në programet europiane të shkëmbimit të personelit dhe studentëve.
5. Mungesa e personelit akademik vendas në disiplina të veçanta. KUB, meqenëse është institucioni i parë në vend që ofron programe studimi në shkencat islame, prezenca e personelit akademik vendas me grada shkencore dhe tituj akademikë përbën një pengesë që duhet kaluar. E njëjta gjë vihet re edhe në disa programe të tjera në disiplina të veçanta.

***Kolegji Universitar “Bedër” është pjesë e një tregu të gjerë institucionesh të arsimit të lartë në Shqipëri. Kjo gjë nxit një konkurrencë të fortë në këtë sektor.***

1. Numri i lartë i institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri, shpesh shfaqet si pengesë për njohjen e institucionit në publik.
2. Të qenit një institucion i ri. Kjo përbën një tjetër pengesë në një treg të gjerë institucionesh të arsimit të lartë, një pjesë e të cilave kanë një historik më të gjatë.
3. Mungesa e programeve të ciklit të tretë. Kjo ka zbehur deridiku mirëfunksionimin e disa qendrave kërkimore-zhvillimore, objekt i të cilave është realizimi i veprimtarive mësimore-shkencore, kryesisht në programet e këtij cikli.

4. Mospërfshirja e deritanishme e institucionit në nismat e BE-së. Pavarësisht se KUB po tregon angazhim në këtë drejtim, momentalisht nuk është pjesë e nismave të BE-së për dhënien e fondeve në projekte të ndryshme shkencore, ku si shkak kufizues në aplikime të tilla të rëndësishme, merret vjetërsia e KUB.

## Lista e evidencave mbështetëse të IAL-së

- Evidenca nr.1:** Statuti i Shkollës së Lartë “Hëna e Plotë” ( Bedër)
- Evidenca nr.2:** Statuti i Kolegjit Universitar “ Bedër”
- Evidenca nr.3:** Rregullorja Themelore
- Evidenca nr.4:** Rregullore “Për organizimin akademik”
- Evidenca nr.5:** Rregullore “Për organizimin administrativ”
- Evidenca nr.6:** Rregullorja “Për studimet e ciklit të parë dhe provimeve”
- Evidenca nr.7:** Rregullorja “Për studimet e ciklit të dytë dhe provimeve”
- Evidenca nr.8:** Rregullorja “Për funksionimin dhe organizimin e Këshillit të Sigurimit të Cilësisë”
- Evidenca nr.9:** Rregullorja “Për funksionimin dhe organizimin e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë”
- Evidenca nr.10:** Rregullorja e anketave dhe vlerësimeve
- Evidenca nr.11:** Rregullorja “Mbi projektet kërkimore shkencore”
- Evidenca nr.12:** Rregullorja e arkivës
- Evidenca nr.13:** Rregulloja “Mbi punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit”
- Evidenca nr.14:** Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore
- Evidenca nr.15:** Rregullorja “Për transferimin e studimeve”
- Evidenca nr.16:** Rregullorja e qendrës kërkimore-zhvillimore “Për shkencat islame”
- Evidenca nr.17:** Rregullorja e qendrës kërkimore-zhvillimore “Për median dhe komunikimin”
- Evidenca nr.18:** Rregullorja “Mbi zbritjen e tarifës së studimit”
- Evidenca nr.19:** Rregullore e një programi (Rregullorja master shkencor në drejtësi profili e drejtë penale dhe e drejtë ndërkombëtare)
- Evidenca nr.20:** Rregullorja e disiplinës së studentëve
- Evidenca nr.21:** Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e komisionit të përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve
- Evidenca nr.22:** Statuti i qendrës së studiueseve të rinj
- Evidenca nr.23:** Udhëzim mbi nxitjen e publikimeve dhe kërkimit shkencor
- Evidenca nr.24:** Udhëzimi “Mbi procesin e zhvillimit të kurrikulave”
- Evidenca nr.25:** Udhëzimin “Për ngarkesën mësimore”
- Evidenca nr.26:** Udhëzimi “Mbi funksionimin e bibliotekës”
- Evidenca nr.27:** Udhëzimi “Mbi klubet studentore”
- Evidenca nr.28:** Procedura e përditësuar e punësimit të stafit
- Evidenca nr.29:** Procedura e punësimit të stafit
- Evidenca nr.30:** Material i detajuar mbi bibliotekën



- Evidenca nr.31:** Procedura e Funksionimit të Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulës
- Evidenca nr.32:** Organigrama
- Evidenca nr.33:** Plani strategjik 2012 – 2017
- Evidenca nr.34:** Vendim i senatit për miratimin e planit strategjik 2012-2017
- Evidenca nr.35:** Vendim i senatit për ndryshimin e planit strategjik
- Evidenca nr.36:** Vendimi i senatit për ndryshimin e rregullores “Për studimet e ciklit të parë dhe provimeve”
- Evidenca nr.37:** Vendime senati për emërimet e ekspertit të jashtëm në Këshillin e Sigurimit të Cilësisë
- Evidenca nr.38:** Vendimi i Këshillit të Ministrave “Për licencimin e Shkollës së Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër)
- Evidenca nr.39:** Vendimi i senatit për përfshirjen e studentëve në organet kolegjiale
- Evidenca nr.40:** Vendimi i senatit për ngritjen e sigorisë dhe shëndetit në punë
- Evidenca nr.41:** Vendimi i Senatit për ngritjen e qendrës së kërkuesve të rinj
- Evidenca nr.42:** Ftesë nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë për aplikim për fillimin e procesit të vlerësimit të jashtëm institucional me Agjencinë Britanike të Sigurimit të Cilësisë
- Evidenca nr.43:** Urdhër nr: 223, datë 4.06.2013 “Për akreditimin institucional dhe të programeve të studimit”
- Evidenca nr.44:** Urdhri i ministres nr. 616, datë 30.12.2016 “Për miratimin e statutit të KUB”
- Evidenca nr.45:** Urdhër mbi ngritjen e grupit të vlerësimit të brendshëm (GVB)
- Evidenca nr.46:** Urdhër për ngritjen e komisionit për hartimin e planit të ri strategjik 2017-2022
- Evidenca nr.47:** Vendime senati për miratimin e ngritjes së komisioneve të përhershme
- Evidenca nr.48:** ISO Certifikatë 9001:2008
- Evidenca nr.49:** Guida e stafit
- Evidenca nr.50:** Guida e studentit
- Evidenca nr.51:** Rregulla mbi organizimin e provimeve
- Evidenca nr.52:** Formular mbi vlerësimin e performancës së stafit akademik
- Evidenca nr.53:** Modeli i kontratës së stafit akademik
- Evidenca nr.54:** Model i kopertinës të librave të konferencave që tregojnë bashkëpunim midis institucioneve
- Evidenca nr.55:** Model i emërimeve i bërë nga një departament për këshilltarët akademik
- Evidenca nr.56:** Raporti i vlerësimit të jashtëm i kërkuar nga IAL
- Evidenca nr.57:** Raporti vjetor institucional
- Evidenca nr.58:** Raportet e aktiviteteve
- Evidenca nr.59:** Dokumentacioni i një mbledhjeje

- Evidenca nr.60:** Shembull “miratimi i buxhetit”
- Evidenca nr.61:** Praktikë e zbatimit të procedurës së rekrutimit
- Evidenca nr.62:** Statistika mbi promovimin e stafit akademik nga viti në vit
- Evidenca nr.63:** Praktika e ndjekur për miratim të kriterëve të pranimit të studentëve
- Evidenca nr.64:** Praktikë e auditimit të brendshëm
- Evidenca nr.65:** Praktikë e mbështetjes financiare për pjesëmarrje në konferenca
- Evidenca nr.66:** Raste praktike shkëmbimi studentësh dhe stafi
- Evidenca nr.67:** Vlerësimi i praktikave mësimore
- Evidenca nr.68:** Udhëzuesi i sigurimit të cilësisë
- Evidenca nr.69:** Shembull flete provimi
- Evidenca nr.70:** Vendime për organizimin e programeve Start Up dhe Mentorship
- Evidenca nr.71:** Njoftim për dorëzimin e raporteve vjetore në rektorat
- Evidenca nr.72:** Modeli i raportit vjetor të departamentit të gjuhës dhe letërsisë angleze
- Evidenca nr.73:** Model diplome dhe Suplementi
- Evidenca nr.74:** Anketa vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentët
- Evidenca nr.75:** Konferenca studentore
- Evidenca nr.76:** Fulbright dhe Mevlana program
- Evidenca nr.77:** Shpërndarja e lëndëve dhe ngarkesa mësimore
- Evidenca nr.78:** Shkëmbimi i stafit dhe studentëve (Mobilitet)
- Evidenca nr.79:** Planveprimi i trajnimeve të stafit
- Evidenca nr.80:** Përshkrimi i punës
- Evidenca nr.81:** Anketë vlerësimi e mendimit të studentëve ndaj institucionit
- Evidenca nr.82:** Aktivitetet e klubeve studentore
- Evidenca nr.83:** Lista e stafit akademik për çdo departament me gradat përkatëse
- Evidenca nr.84:** Statistika të studentëve të diplomuar dhe angazhimi i tyre
- Evidenca nr.85:** Lista e të diplomuarve, statistika
- Evidenca nr.86:** Lista e botimeve të stafit akademik
- Evidenca nr.87:** Lista e programeve dhe një shembull programi
- Evidenca nr.88:** Listë e praktikave studentore
- Evidenca nr.89:** Lista e infrastrukturës teknologjike
- Evidenca nr.90:** Konferencat shkencore
- Evidenca nr.91:** Projektet me institucionet e tjera
- Evidenca nr.92:** Lista e institucioneve partnere
- Evidenca nr.93:** Akti higjieno-sanitar
- Evidenca nr.94:** Akti teknik për mbrojtjen nga zjarri

- Evidenca nr.95:** Certifikata e pronësisë dhe plani i kampusit
- Evidenca nr.96:** Planimetria i godinës aktuale
- Evidenca nr.97:** Kontrata me kompaninë e sigurisë ALSIG
- Evidenca nr.98:** Kontrata me Albpastrim
- Evidenca nr.99:** Marrëveshja me spitalin amerikan
- Evidenca nr.100:** Kontrata me British Council
- Evidenca nr.101:** Marrëveshja me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
- Evidenca nr.102:** Marrëveshja me Ministrinë e Brendshme
- Evidenca nr.103:** Kontrata e qirasë me USLUGA
- Evidenca nr.104:** Projektet e aplikuar
- Evidenca nr.105:** Konkursi studentor për tezën më të mirë
- Evidenca nr.106:** Aktivitetet e dialogut ndërfetare të organizuara nga IAL
- Evidenca nr.107:** Ambientet në KUB
- Evidenca nr.108:** Udhëzues i sistemit informativ bedër (BIS)
- Evidenca nr.109:** Statistika e bursave në formë zbritje tarife studimi ndër vite





Adresa: Rr "Jordan Misja", Tiranë - Shqipëri  
Kontakt: Tel + 355 4 24 19 222  
Fax: +355 4 24 19 333 e-mail: [info@beder.edu.al](mailto:info@beder.edu.al)  
[www.beder.edu.al](http://www.beder.edu.al)